



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 264 Akti

Nr. 305 Vendimi
Tiranë, më 8.10.2020

VE N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici
Firdes Shuli
Brunilda Bekteshi

Kryesues
Relator
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datat 7.10.2020 dhe 8.10.2020, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Afërdita Ndoi**, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Afërdita Ndoi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”);

2. Znj. Afërdita Ndoi, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.1.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bektashi dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.10.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi.

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 17.12.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 12.12.2019. të KDZH-së.

6. Me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2020, KLP-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi.

7. Me vendimin nr. 1, datë 21.1.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Afërdita Ndoi, duke u bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Në datën 21.2.2019, subjektit i’u komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke i’u bërë me dije dhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti deklaroi se nuk ka asnjë shkak ligjor përjashtimi apo dorëheqje me ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues.

9. Me vendimin nr. 2, datë 27.7.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit, të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

10. Në datën 29.7.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 8.9.2020, për shkak të lejes vjetore; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Në datën 8.9.2020, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

12. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion, njoftoi subjektin me anë të postës elektronike mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 16.09.2020.

13. Në datë 15.9.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, u administrua një denoncim anonim protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.9.2020.

14. Me vendimin nr. 3, datë 15.9.2020, Komisioni vendosi të riçelë hetimin administrativ për të kryer veprime të mëtejshme hetimore në lidhje me denoncimin e paraqitur dhe të shtyjë seancën dëgjimore.

15. Në datën 02.10.2020, subjektit iu derguan rezultatet e hetimit administrativ shtesë.

16. Në datën 6.10.2020, subjekti i rivlerësimit dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrimet mbi rezultatet shtesë të hetimit administrativ dhe provat në mbështetje të tyre.

17. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, njoftoi subjektin me anë të postës elektronike mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 7.10.2020.

18. Në datën 7.10.2020, u zhvillua seanca dëgjimore, në përfundim të së cilës, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe ka dorëzuar deklaratat e interesave private ndër vite (ne vijim DPV) për periudhën 2003 – 2017. Në datën 26.1.2017, subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 17.10.2018, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion

dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me:

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si vijojnë:

1. Apartament me sipërfaqe 66.2, m², Njësia Bashkiake Farkë, Rr. “****”, ndërtesa *** ap. ***, kati ***, ***, e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë sipas kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 2.12.2010. Ky apartament është blerë me kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit. Vlera: 25.056 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar: Mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 66.2 m², Farkë, Tiranë në vitin 2009, në vlerën 25.056 euro, vlerë e cila është paguar ditën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes datë 19.2.2009

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe rivlerësimi i kësaj pasurie

1.1 Në lidhje me statusin aktual të pasurisë:

- ZVRPP-ja Tiranë¹ konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit G. N. (bashkëshorti i subjektit) pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sipërfaqe 66.2 m².
- OSHEE² konfirmoi se shtetasi G. N. është abonent me nr. kontrate *** në instancën e Tiranës, Selitë. Referuar detajeve të pagesave³ vërehet se ato nisin në mars të vitit 2010.

1.2 Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë u kryen të gjitha verifikimet dhe bazuar në provat e administruara⁴, u vërtetua se:

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 18.11.2010, pasuria e llojit apartament me sip. 66.2 m², e ndodhur në Selitë me nr. pasurie ***, ishte e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.
- sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 19.2.2009, porositi G. N. ka porositur te shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me siperfaqe totale 78.3 m², së bashku me ambientet ndihmëse prej 12.1 m².
- sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 1.12.2010, shtetasi G. N. ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 66.2 m², me çmim 25.056 euro. Pavarësisht këtij çmimi, shuma reale e paguar nga subjekti është ajo e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, prej 25.219 euro, vërtetuar me deklaratimet e subjektit, si dhe me deklaratën noteriale të lëshuar në datën 24.4.2020 të lëshuar nga administratori i “****” sh.p.k., z. R. Z.⁵

¹Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 6.3.2019 nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

²Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 4.5.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

³Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 19.3.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

⁴Shih aktet në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 21.4.2020, dërguar nga subjekti më 30.4.2020, në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëngjitur.

- sipas shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 6.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, kjo pasuri është e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, z. G. N., me nr. ***, me sip. 66.2 m².

Në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua se pasuria është përfituar në mënyrë të ligjshme nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

1.3. Në lidhje me deklaramet e subjektit për këtë pasuri, rezultoi se:

- Në deklaramin për vitin 2009 është deklaruar: “*Apartament banimi me sip 78.3 m², komuna ***, Selitë, e identifikuar me emërtimin (ap. ***) i ndodhur në katin përdhe, i marrë në bazë të kontratës së sipërmarrjes, nr. ***, datë 19.2.2009, pranë noteres A. M., e paregjistruar në hipotekë. Vlera: 25.219 euro e konvertuar në 2.644.400 lekë, në kohën e blerjes*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Mospërputhja në deklaramin e subjektit për këtë vit dhe informacionit të marrë nga ZVRPP-ja, në lidhje me sipërfaqen e deklaruar në kontratën e porosisë 78.3 m², ka ardhur si pasojë e përfshirjes të sipërfaqeve ndihmëse, pasi në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 19.2.2009, sipërfaqja totale është 78.3 m², përfshirë ambientet e përbashkëta. Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 1.12.2010, sipërfaqja është shenuar 66.2 m², aq sa është regjistruar në ZVRPP, ç’ka tregon se në këtë kontratë nuk është përfshirë sipërfaqja e përbashkët prej 12.1 m².F

- Në deklaratën *Vetting* është deklaruar si në pikën 1 më sipër.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi mosdeklaramin e burimit të krijimit të pasurisë në DPV-në e vitit 2009, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Në parashtrimet e tij, në lidhje me këtë konstatim, subjekti deklaroi se i vetmi burim i krijimit të pasurive që ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur dhe kanë aktualisht, kanë qenë vetëm të ardhurat nga pagat, të cilat janë deklaruar çdo vit sipas detyrimit ligjor. Në këto kushte, duke qenë se nuk kanë pasur asnjë të ardhur tjetër përveç pagës, kanë çmuar se me deklaramin e të ardhurave kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklaramin e burimit të krijimit të çdo lloj pasurie që disponojmë. Më tej, subjekti ka sqaruar se në DVP-në e vitit 2009, plotësuar nga bashkëshorti, z. G. N., në rubrikën “të dhëna konfidenciale” është deklaruar se burimi i të ardhurave të apartamentit janë kursimet e saj dhe të bashkëshortit ndër vite, dhe për këto arsye, kërkon që kjo pasaktësi të vlerësohet sipas kontekstit të sipërcituar, e kryer në mirëbesim.

Pas verifikimit të rubrikës “të dhëna konfidenciale” në DPV-në e vitit 2009, u konstatua se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhura të kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Këto të ardhura, në përfundim të hetimit administrativ, rezultuan të deklaruara rregullisht si nga subjekti ashtu edhe nga bashkëshorti, si dhe të mjaftueshme për blerjen e pasurisë. Për rrjedhojë, Komisioni i çmoi bindëse shpegimet e subjektit dhe nuk e konsideroi mungesën e deklaramit të burimit në rubrikën “deklarami i pasurive” te DPV për vitin 2009, si deklaram të pamjaftueshëm.

1.4 Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial për blerjen e pasurisë

Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2010”, rezulton se për zonën 5/4 ku ndodhet apartamenti në Selitë, çmimi në tregun e lirë në vitin 2009 ishte 88.000 lekë/m². Referuar çmimit të tregut, apartamenti i blerë do të kushtonte 66.2 m² x 88.000 lekë/m² = 5.825600 lekë, ndërkohë që ka kushtuar 25.219 euro ose 3.459.290 lekë.

Me qëllim evidentimin e faktit nëse subjekti është trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e pasurisë në çmimin 25.219 euro, për shkak të statusit të saj si prokurore, u kryen disa verifikime, në përfundim të të cilave:

(i) Nuk u vërtetua që administratori i shoqërisë shtetasi R. Z. dhe shoqëria “****” sh.p.k. të kenë qenë pjesëmarrës me çdo lloj statusi në çështje penale të shqyrtuara prej subjektit të rivlerësimit si prokurore⁶.

(ii) SPAK⁷ informoi se ndaj shtetasit R. Z. nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

(iii) Me kërkesë të Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k. ka vënë në dispozicion⁸ katër kontrata të ngjashme sipërmarrjeje (porosie) si vijojnë:

1. kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 16.4.2008, me objekt apartament me sip. 76.4 m², me çmim total 24.448 euro (320 euro/m²);
2. kontratë porosie nr. ***, datë 9.6.2009, me objekt apartament me sip. 73 m², me çmim 23.360 euro (320 euro/m²);
3. kontratë porosie nr. ***, datë 11.4.2007, me objekt apartament me sip. 73.2 m², me çmim 42.456 euro (580 euro/m²);
4. kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 26.1.2007, me objekt apartament me sip. 82.2 m², me çmim 48.000 euro (584 euro/m²).

(iv) Me kërkesë të Komisionit, ASHK-ja Tirana Rurale 1 vuri në dispozicion katër kopje të kontratave të shitjes të disa apartamenteve të tjera në të njëjtën godinë, shitur nga shoqëria “****” sh.p.k.⁹ si vijojnë:

1. kontratë shitje nr. ***, datë 17.11.2011, me objekt apartament me sip. 67.8 m² me çmim 25 764 euro (380 euro/m²);
2. kontratë shitje nr. ***, datë 21.12.2011, me objekt garazhd me sip. 20 m² me çmim 5.320 euro (266 euro/m²);
3. kontratë shitje nr. ***, datë 30.5.2011, me objekt apartament me sip. 70.9 m² me çmim 22.688 euro (320 euro/m²);
4. kontratë shitje nr. *** datë 3.6.2013 me objekt apartament me sip. 70.9 m² me çmim 26,942 euro (380 euro/m²).

Nga të dhënat e tetë kontratave të sipërpërmendura, referuar çmimit të blerjes prej 381 euro/m² nga subjekti, rezultoi se vetëm në dy raste kontratat parashikojnë çmime më të larta se ky çmim. Në rastet e tjera, çmimi për m² është aq sa çmimi i përcaktuar për subjektin ose dhe më i ulët.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, nga Komisioni nuk janë evidentuar elementë të trajtimit në mënyrë preferenciale të subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të detyrës. Ndërsa, u vlerësua se blerja e pasurisë në çmimin prej 25.219 euro, ka qenë për shkak të vullnetit të lirë të palëve, në konsideratë edhe të pozicionit jo të favorshëm në të

⁶ Shih vërtetim nr.*** prot., datë 25.3.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën 2009 e deri sot; vërtetim nr. *** prot., datë 11.3.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për periudhën tetor 2002 - tetor 2003; vërtetim nr. *** prot., datë 19.3.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për periudhën tetor 2003 - shkurt 2009; vërtetim nr. *** prot., (A.O), datë 19.3.2020 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën prill 2019 e deri sot, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

⁷ Shih shkresë kthim-përgjigje nr. ***, datë 4.5.2020, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

⁸Shih dokumentet bashkëngjitur shkresës së protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.5.2020, nga shoqëria “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

⁹ Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 2.6.2020 nga ASHK Tirana Rurale 1, në dosjen e Komisionit.

cilin ndodhej apartamenti, kati përdhe, ashtu sikurse ZVRPP ka konfirmuar dhe subjekti ka deklaruar : ... në këtë pallat, i vetmi apartament banimi i paprenotuar, apartamenti që sot ne kemi në pronësi, ishte në katin përdhe të ndërtesës dhe me orientim veri, sipërfaqe shumë të vogël, pozicioni e arkitektura e apartamentit jo shumë e përshtatshme, pozicionimi nuk siguronte ndriçim natyral të mjaftueshëm...

1.5. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes

Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 19.2.2009, çmimi prej 25.219 euro është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale, por, pa përcaktuar periudhën/periudhat konkrete të likuidimit të tij. Gjatë hetimit administrativ, u pyet subjekti i rivlerësimit në lidhje me mënyrën si ishte likuiduar çmimi për blerjen e pasurisë, si dhe iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore likuidimin e shumës prej 25.219 euro.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, znj. Afërdita Ndoi deklaroi se nuk ka mundur të sigurojë dokumente pasi nuk kanë treguar kujdesin e duhur për ruajtjen e tyre, për shkak se nuk ka qënë detyrim as për t'i dorëzuar dhe as për ti ruajtur, si dhe për shkak të kohës se gjatë që ka kaluar. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion nje deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.4.2020, të shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori R. Z., në të cilën deklaroi se z. G. N. e ka likuiduar çmimin e shitblerjes së apartamentit prej 25.219 euro me nënshkrimin e kontratës së

Ndërsa, në përgjigjet e datës 23.7.2020, subjekti vuri në dispozicion shkresë kthim-përgjigje me datë 23.7.2020 të shoqërisë “****” sh.p.k., me anë të të cilës kjo shoqëri informon se nga kontrolli i listës së klientëve të shoqërisë të ruajtur në mënyrë elektronike, rezulton se pagesat për shlyerjen e detyrimeve të kësaj kontrate nga z. G. N. janë kryer me katër këste si vijon:

- pagesa e parë është kryer në datën 2.5.2007 nga z. N. V. (babai i subjektit) për llogari të z. G. N. në shumën 10.000 euro, vërtetuar me kopje *dublikate* të mandatarkëtimit nr. ***, datë 2.5.2007, me përshkrimin “*lic (likujdim) cash për llog të G. N.*” ;
- pagesa e dytë është kryer në datën 26.12.2007 nga z. G. N. në shumën 5.000 euro, vërtetuar me kopje *dublikate* të mandatarkëtimit nr. ***, datë 26.12.2007, me përshkrimin “*lic cash*”;
- pagesa e tretë është kryer në datën 11.12.2008, nga z. G. N. në shumën 8.219 euro, vërtetuar me kopje *dublikate* të mandatarkëtimit nr. ***, datë 11.12.2008, me përshkrimin “*lic kesh*” ;
- pagesa e katërt është kryer në datën 19.2.2009, nga z. G. N. në shumën 2.000 euro, vërtetuar me kopje *dublikate* të mandatarkëtimit nr. ***, datë 19.2.2009, me përshkrimin “*lic cash*”.

1.6. Në lidhje me burimin e krijimit

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit, deklaratë e cila përputhet me deklarinimin e bashkëshortit të saj në rubrikën “ të dhëna konfidenciale ” në DPV-në e vitit 2009, ku si burim janë deklaruar të ardhura të kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Nga verifikimi i dokumenteve shkresore, rezultoi se që nga data 1.1.2009 deri në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, datë 19.2.2009, subjekti ka pasur të ardhura nga pagat në shumën 162.261 lekë, ndërsa bashkëshorti në shumën 147.862 lekë, shuma të cilat u përfshinë si të ardhura ligjore në analizën financiare.

Për sa i takon likuiditeteve *cash*, nga verifikimi i DPV, rezultoi se: (i) në DPV/2003 është deklaruar gjendja *cash* 200.000 lekë me burim kursimet nga pagat; (ii) në DPV/2004, është deklaruar e gjendje *cash* 510.000 lekë me burim kursime nga pagat e ketij viti. Shuma e akumuluar prej 710.000 lekësh është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën financiare; (iii) në DPV/2005 dhe deri në vitin 2008, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Me qëllim qartësimin e situatës në lidhje me gjendjet e likuiditeteve në fund të çdo viti, është pyetur subjekti dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sqaruar se: *“Në vitin 2003 gjendja e cashit ka qenë 200.000 lekë; në vitin 2004 gjendja e cash-it është shtuar me 510.000 lekë; për vitet 2005 – 2008, nuk mund të deklarojmë me saktësi të plotë se sa ka qenë gjendja cash në fund të këtyre viteve,... në kushtet kur nuk kemi evidentuar shtesat, e kemi të pamundur të përcaktojmë se sa ka qenë gjendja fiks e cash-it në datë 31 dhjetor të kësaj periudhe. Por në datën 19.2.2009 gjendja e të gjitha kursimeve të të ardhurave nga paga është 25.219 euro; në fund të vitit 2009 nuk kemi pasur gjendje cash; në në fund të vitit 2010 nuk kemi gjendje cash; në fund të vitit vitit 2011 gjendja cash është 850.000 lekë; në fund të vitit 2012 gjendja cash është shtuar me 300.000 lekë; në fund të vitit 2013 gjendja cash është shtuar me 350,000 lekë; në fund të vitit 2014 gjendja cash është shtuar me 513,000 lekë; në fund të vitit 2015 gjendja e cash nuk ka ndryshuar; në fund të vitit 2016 gjendja cash është zvogëluar me 1.750 euro plus shpenzimet për udhëtim të cituara në deklaratën e këtij viti”*

Nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ, u konstatua se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura nga pagat për të krijuar kursime në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008, ashtu sikurse pretendon. Por, duke qenë se këto kursime nuk janë deklaruar në DPV-të përkatëse të këtyre viteve as si shtesa likuiditetesh dhe as si gjendje *cash*, si dhe në mungesë të një dokumenti shkresor që të vërtetonte marrëdhënien midis palëve që në vitin 2007 sipas konfirmimit nga ana e shoqërisë ndërtimore me shkresë kthim-përgjigje të datës 23.7.2020, në përfundim të hetimit administrativ, kursimet nga pagat gjatë këtyre viteve nuk janë marrë në konsideratë si e ardhur e ligjshme gjatë analizës financiare, fakt që ka sjellë si pasojë një balancë negative prej - 2.642.298 lekësh. Pra, në analizën financiare të dërguar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit, e gjithë vlera e çmimit të blerjes së pasurisë, është konsideruar e shlyer tërësisht në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, datë 10.2.2009, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë (vlera në lekë është llogaritur referuar kursit të shkëmbimit të euros të datës 19.2.2009).

Përshkrimi	19.02.2009
Pasuri	2.729.058
Apartament banimi me sip. 66,2 m ² , Komuna Farkë	3.459.290
<i>Pakesime likuiditete</i>	-730.232
Të ardhura	310.123
Të ardhura nga pagat subjekti	162.261
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	147.862
Shpenzime	223.363
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	73.363
Shpenzime shkollimi djali	150.000
Mundësia për kursime	-2.642.298

Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova, shpjegime dhe dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, si vijon:

- subjekti nuk ka deklaruar shtesa të likuiditeteve dhe as gjendje *cash* për vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008 sipas detyrimit të parashikuar në nenin 4, germa “d”, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar;

-subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të për vitet 2007 dhe 2008 asnjë fakt për pasurine, pagesat e kryera gjatë këtyre viteve, vite në të cilat nuk ka deklaruar pakësime të likuiditeteve, si dhe detyrimet financiare ndaj shoqërisë ndërtimore;

- për shkaqet e mësipërme, kursimet për vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008 nuk janë përfshirë në analizën financiare dhe, për pasojë, duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshem të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, pasi rezultoi me një balancë negative prej -2.642.298 lekë.

-mbetet e paqartë kryerja e pagesave në vitin 2007, 2008 dhe 2009, sipas katër mandatpagesave *dublikate* të paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, në mungesë të një akti që vërteton porositjen apo blerjen e apartamentit në vitin 2007, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. është lidhur në datën 19.2.2009.

- Subjekti duhet të provojë vërtetësinë e pagesave të kryera sipas katër mandatpagesave *dublikate*, duke vënë në dispozicion çdo lloj dokumentacioni shkresor si: bilancet kontabël i shoqërisë ndërtimore, pasqyrat financiare me shënimet shpjeguese, raporte të ekspertëve kontabël (nëse ka) për periudhën 2007, 2008, 2009, raporte kontrolli që përfshijnë këto bilance/pasqyra financiare, si dhe dokumentacionin, pjesë e dosjes së kontrollit tatimor, librat e shitjes, si dhe formularët e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së për këtë periudhë, etj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit në lidhje me çdo pretendim

Së pari, në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes *cash* dhe shtesave të likuiditeteve në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008, subjekti ka sqaruar se kjo pasaktësi lidhej me konfuzionin që të krijonte formulari i deklarimit të pasurisë, në të cilin nuk kishte një vend specifik ku të deklaroheshin gjendja e kursimeve *cash*, por, kryesisht për faktin se deklaratat janë plotësuar gjatë periudhës së lejes së lindjes e duke mos i disponuar deklaratat e mëparshme, periudhë në të cilën kanë ndodhur ndryshime të shumta në jetën e saj, si ndryshimi i vendbanimit pasi në vitin 2005 janë zhvendosur në Lezhë, martesë dhe ardhja në jetë e dy fëmijëve. Sipas subjektit, fakti që ka qenë thjesht pakujdesi, provohet edhe nga *statementet* bankare të cilat rezultojnë me vlera pozitive në çdo fund-viti, çka tregonin pasjen e kursimeve në llogaritë bankare.

Përkundër sa pretendohet nga subjekti, Komisioni çmon se dispozitat ligjore lidhur me këtë detyrim nuk lënë vend për konfuzion, pasi përveç përcaktimit shprehimisht të objektit të deklarimit në nenin 4 të ligjit nr. 9049, në DPV-të për vitet 2005 dhe 2006, në rubrikën “deklarimi i interesave private” jepen shpjegime të qarta se në deklarim duhet të pasqyrohen shtesat dhe ndryshimet e interesave pasurore, përfshirë gjendjen *cash*, llogari rrjedhëse, depozitë etj. Ndërsa në DPV-të për vitet 2007- 2008, rubrika “deklarimi i interesave private” është ndryshuar në “ ndryshimet e interesave private”, çka përsëri nuk lë vend për konfuzion.

Për sa i takon pretendimit në lidhje me ndryshime në jetën e subjektit gjatë kësaj periudhe, është vërtetuar se në DPV-të për vitet 2005 dhe 2007, janë plotësuar nga subjekti brenda datës 31 mars të vitit pasardhës përkatës, kohë e cila përkon me zhvendosjen e subjektit familjarisht në Lezhë ku ka punuar në periudhën janar 2006 – dhjetor 2009¹⁰, martesën në datën 21.3.2005, si dhe me periudhat e lindjes së dy fëmijëve të saj, përkatësisht në datën 17.7.2005 dhe më 21.10.2007¹¹, pasuar me lejet përkatëse të lindjeve¹². Këto rrethana, vlerësohen nga Komisioni si shkaqe objektive që mund të kenë favorizuar mungesën e vëmendjes dhe pakujdesinë e subjektit gjatë plotësimit të DPV-ve të këtyre viteve.

¹⁰Referuar raportit të aftësive profesionale, për periudhën janar 2006 – dhjetor 2009, subjekti ka ushtruar funksionin në Prokurorinë e Lezhës.

¹¹Fëmija i parë ka lindur në datën 17.7.2005 ndërsa DPV/2005 është hartuar dhe dorëzuar në datën 20.3.2006; fëmija i dytë ka lindur në datën 21.10.2007, ndërsa DPV/2007 është hartuar dhe dorëzuar në datën 4.3.2008.

¹²Shkresë nr. ***, datë 7.10.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Lezhë, ka bashkëlidhur - vërtetim nga ISSH ku rezultoi se për periudhën korrik 2006 deri në mars 2007, subjekti ka qenë me raport. Po kështu sipas lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank” ka kreditime deri në datën 25.2.2008 me përshkrimin “përfitim afatshurtër”.

Por, sa i takon mosdeklarimit të gjendjeve *cash*, për të cilin subjektit i është kaluar barra e provës, nga analizimi me kujdes i deklaratave peridike dhe rrethanave të çështjes rezulton se, subjekti në fakt nuk ka pasur likuiditete në *cash* gjatë viteve 2005-2009. Ndërsa, nga analizimi i shpjegimeve të subjektit, konstatohet se ai e lidh përdorimin e të gjithë likuiditeteve në *cash* (si dhe atyre në banka) me blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi. Pavarësisht faktit se subjekti në deklaratimet e tij përgjatë hetimit administrativ por dhe në parashtrime, nuk e përdor këtë fakt si një argument të posaçëm për të provuar vërtetësinë e deklaratimeve të tij, Komisioni vlerësoi ta evidentojë këtë situatë referuar pikërisht deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit duke ndjekur rrjedhën logjike e kronologjike të tyre ndër vite, të cilat, në përfundim të procesit u vërtetuan të jenë të jenë të sakta, pasi:

(i) për vitin 2003 ka deklaruar gjendjen *cash* prej 200.000 lekësh;

(ii) për vitin 2004 ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në shumën 510.000 lekë;

(iii) për vitet 2005 – 2009, subjekti nuk ka kryer deklaratime të gjendjeve *cash*, pasi siç do të arsyetohet në mënyrë me të hollësishme në vijim, në periudha të ndryshme kohore, *cash*-in e mbartur nga viti 2004 prej 710,000 lekësh e që vijon deri në fund të vitit 2006, si dhe shumat e tërhequra nga llogaritë bankare në vitet 2007, 2008 dhe 2009, subjekti i ka përdorur për të kryer pagesat për shoqërinë “****” sh.p.k. Pra, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* për vitet 2005 – 2009, për shkak se të gjitha kursimet nuk i ka akumuluar por i ka përdorur për blerjen e pasurisë. Vlen të theksohet se gjatë këtyre viteve, nuk u konstatuan investime të bashkëshortëve. Ndoi për blerjen e ndonjë pasurie tjetër dhe as shpenzime të cfarëdolloji përveç pak udhëtimeve të evidentuara në sistemin TIM, shpenzime të cilat të cilat u perfshinë në analizën financiare.

(iv) Në vijim, në vitin 2010, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, për shkak se ka kryer dhe deklaruar shpenzime arredimi në shumën 850.000 lekë, vërtetuar me të ardhura të ligjshme.

(v) Në vijim, në DPV-në për vitet 2011 – 2016, subjekti ka deklaruar rregullisht kursime në *cash*.

Megjithatë, subjekti nuk ka deklaruar sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, pagesat e kryera për blerjen e pasurisë, si dhe pakësime të likuiditeteve për shkak të kryerjes së këtyre pagesave gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, fakte të cilat i bëjnë të pasakta deklaratimet për këto vite.

Së dyti, në lidhje me mosdeklarimin në DPV-të për vitet 2007 dhe 2008, të pasurisë objekt shqyrtimi dhe pagesave të kryera, si dhe modeklarimit të detyrimeve financiare të prapambetura ndaj shoqërisë, në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se që në vitin 2007 kur ishte në kërkim të një apartamenti për familjen e saj, pati një marrëdhënie mirëbesimi verbale me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila u angazhua në gjetjen e alternativave të tjera të banimit, në kushtet kur po ndërtonte edhe dy pallate të tjera. Sipas subjektit, kjo lloj marrëdhënie nuk hynte në llojin e marrëdhënieve për të cilat ekzistonte detyrimi i deklarimit, pasi nuk ishte përcaktuar përfundimisht objekti pasuri e paluajtshme dhe as të drejtat reale mbi të dhe, si pasojë, as pagesat e kryera shoqërisë “****” sh.p.k. Për më tepër, sipas saj, këto pagesa janë konsideruar si shpenzime të kryera, të cilat nuk kishte si ti deklaronte për shkak të mungesës së legjislacionit në atë periudhë.

Për sa i takon qëndrimin që duhet të mbajë Komisioni ndaj pasaktësive të mësipërme, subjekti ka sjellë në vëmendje vendimin e formës së prerë nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit, në të cilin theksohet se : *“Komisioni vlerëson se kompetenca me të cilën Kushtetuta dhe ligji kanë ngarkuar këtë organ për të ushtruar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që hetohen dhe gjykohen. Përkundrazi, Komisioni gjatë hulumtimit dhe zbatimit të detyrave funksionale duhet që këto pasaktësi t’i shoqërojë me konkluzionin se janë pikërisht ato mjetet*

me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj.... kjo do të thotë që nëse pasaktësia ose mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrësi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore nga ana e organeve vendimarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar”.

Pavarësisht nga sa ka pretenduar dhe referuar subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se në DPV-të për vitet 2007 dhe 2008 dhe 2009, subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pakësime të likuiditeteve në rubrikën “ndryshimet e interesave private” për shkak të pagesave të pretenduara të kryera shoqërisë “****” sh.p.k., detyrim të cilin nuk rezulton ta ketë përmbushur.

Nga ana tjetër, subjekti deklaron se këto pagesa i ka konsideruar si shpenzime të kryera, të cilat nuk i ka deklaruar për shkak se deklarimi i shpenzimeve në këto vite nuk parashikohej nga legjislacioni i kohës, pretendim i cili në fakt qëndron, pasi koncepti “shpenzimeve të deklarueshme” u parashikua në ligj me ndryshimet që ju bënë ligjit nr. 9049, në vitin 2012, me të cilat u parashikua detyrimi i deklarimit të shpenzimeve të deklarueshme me vlerë mbi 500.000 lekë, që më pas, në vitin 2014, kjo vlerë u ul në mbi 300.000 lekë.

Për sa i takon mosdeklarimit të pasurisë në DPV-të për vitet 2007 dhe 2008, subjekti me të drejtë pretendon se nuk ka pasur një marrëveshje të materializuar me shoqërinë ndërtimore dhe as kishte fituar të drejta reale të pronësisë, sepse objekti akoma nuk ekzistonte.

Për sa i takon modeklarimit të detyrimeve financiare ndaj shoqërisë ndërtimore, Komisioni çmon se, pikërisht për shkak të mospasjes së një marrëveshje me shkrim midis palëve, subjektit nuk i ka lindur detyrimi për të deklaruar detyrime financiare ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

Së treti, në lidhje me kursimet e krijuara gjatë viteve 2005, 2006, 2007 dhe 2008 të cilat Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë gjatë analizës financiare të vënë në dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit duke pretenduar se këto kursime janë krijuar me të ardhura nga pagat dhe se gjatë hetimit administrativ është vërtetuar që këto kursime janë përdorur për pagesën e plotë të çmimit të shitjes të apartamentit. Në këtë mënyrë subjekti, lë të kuptohet se faktikisht nuk ka krijuar gjendje *cash*, pasi të gjitha kursimet janë tërhequr nga bankat dhe përdorur, pikërisht, për të kryer pagesat për blerjen e pasurisë gjatë viteve 2007, 2008 dhe pjesërisht në vitin 2009, sipas katër mandatpagesave të vëna në dispozicion nga shoqëria ndërtimore. Subjekti pretendon se pa të drejtë Komisioni ka kryer analizën financiare me gjendjen e të ardhurave në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, datë 19.2.2009, duke mos përfshirë në këtë analizë kursimet me të ardhurat nga pagat në vitet e mëparshme dhe ka paraqitur një analizë financiare ku këto të ardhura janë të përfshira, dhe sipas të cilës rezultojnë një balancë pozitive.

Për sa i takon këtij pretendimi, ashtu sikurse është konstatuar edhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka evidentuar se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* për vitet 2003 dhe 2004 me burim të ardhurat nga pagat në shumën totale 710.000 lekë. Për vitet 2005 dhe 2006, nuk ka pasur ndryshime në gjendjet e likuiditeteve në *cash* duke bërë kështu që e njëjta shumë *cash* prej 710.000 lekësh të mbartet deri në fund të vitit 2006. Ndërsa, sa i takon likuiditeteve në banka për vitet 2007, 2008 dhe 2009, pretendimi i subjektit qëndron, pasi është vërtetuar që subjekti ka pasur mundësi për të krijuar kursime me të ardhura nga pagat e saj dhe të bashkëshortit të depozituara në llogaritë bankare pranë “Credins Bank” dhe “Raiffeisen Bank”. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare pranë këtyre bankave, u evidentua të jenë kryer disa tërheqje përpara ose në momentin e pagesave të kryera ndaj shoqërisë ndërtimore, ashtu sikurse subjekti pretendon. Konkretisht:

(i) Në datën 30.4.2007, pra, dy ditë më parë nga pagesa e këstit prej 10.000 euro, sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 2.5.2007, nga “Credins Bank” janë tërhequr shumat 330.000 lekë¹³ dhe 314.365 lekë, gjithësej shuma 644.365 lekë. Pjesa tjetër, përbëhet nga të ardhurat *neto* në shumën 165.310 lekë¹⁴ plus një pjesë nga gjendja *cash* e mbartur që nga viti 2004.

(ii) Gjatë periudhës 2.5.2007 – 26.12.2007, që është data e pagesës së këstit të dytë në shumën 5.000 euro sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 26.12.2007, nga “Raiffeisen Bank” është tërhequr shuma në total prej 1.087.000 lekë¹⁵.

(iii) Nga 1.1.2008 – 11.12.2008, kur është bërë pagesa e këstit të tretë prej 8.219 euro sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 11.12.2008, është tërhequr nga llogaritë e pagave të bashkëshortëve në “Raiffeisen Bank”, shuma në total prej 1, 825, 500 lekësh¹⁶.

(iv) Nga data 1.1.2009 – 19.2.2009, kur është bërë pagesa e këstit të katërt prej 2.000 euro sipas mandatpagesës nr. ***, datë 19.2.2009, është tërhequr nga llogaritë e pagave të bashkëshortëve në “Raiffeisen Bank” në total shuma prej 307.000 lekësh¹⁷.

Së katërtri, në lidhje me kryerjen e pagesave në vitet 2007 dhe 2008 pa pasur një marrëveshje me shkrim të palëve, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. është lidhur në datën 19.2.2009, subjekti ka shpjeguar rrethanat e negociimit gjatë këtyre viteve me shoqërinë “****” sh.p.k., për angazhimin e kësaj të fundit në gjetjen e një apartamenti, bazuar në një marrëdhënie verbale mirëbesimi, si vijon: “... rrethi jonë familjar dhe shoqëror ndodhej në Tiranë, ndaj dhe si familje e re, synimi ynë ishte jetesa në Tirane. Në vitin 2007 na sugjeruan zonën e Selitës dhe filluam kërkimin për apartament banimi të përshtatshëm për familjen me 4 persona dhe afër mundësisë sonë financiare. Midis objekteve të vizituar ishte dhe pallati në ndërtim nga shoqëria “****” shpk. Në këtë pallat, i vetmi apartament banimi i paprenotuar (apartamenti që sot ne kemi në pronësi) ishte në katin përdhe të ndërtesës dhe me orientim veri, sipërfaqe shumë të vogël, pozicioni e arkitektura e apartamentit jo shumë e përshtatshme, pozicionimi nuk siguronte ndriçimi natyral tënjatueshëm. Nisur nga këto arsye nuk ishte zgjedhja më e mirë, ndaj dhe hezitua. Duke parë hezitimin tonë, por edhe mundësitë tona financiare, ndërtuesi u angazhua që të krijonte mundësinë, që në rast se nuk ishte e ngutshme marrja e apartamentit, me të njëjtin çmim, do të na ofronte dhe alternativa të tjera zgjedhje pasi kishte nisur ndërtimin e dy pallateve të tjera ngjitur me objektin ku ndodhej apartamenti në fjalë. Për këto arsye nuk kemi përpiluar një kontratë paraprake, pasi siç sqaruam marrëveshja ishte e hapur. Ne do vazhdonim me pagesat dhe ndërtuesi do të shikonte mundësinë e ndonjë alternative tjetër (apartamenti tjetër në pallatet e tjerë në ndërtim prej tij), me të njëjtin çmim për m²...”.

Për sa i takon momentit të likuidimit të çmimit të shitjes së pasurisë, subjekti ka pretenduar se ky çmim nuk është paguar në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, datë 19.2.2009, por më parë, gjatë viteve 2007, 2008, duke përfunduar në vitin 2009, ashtu sikurse shoqëria ndërtimore ka konfirmuar. Sipas subjektit, nëse likuidimi i çmimit do të ndodhte atë ditë, pra, në datën 19.2.2009, ky fakt do të pasqyrohej shprehimisht në kontratë, sikurse është pasqyruar në kontratat e ngjashme me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe porositësat Y. A. (kontratë e datës 11.4.2007), E. L. (kontratë e datës 26.1.2007), A. Sh. (kontratë e datës 9.6.2009), kontrata të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Në vijim,

¹³Shuma është depozituar *cash* fillimisht, në datën 10.1.2007 në “Credins Bank”. Kjo shumë është krijuar nga 4 tërheqjeje në datat 4, 9 dhe 10 Janar 2007, nga llogaritë e pagave respektive të të dy b/shortëve, në “Raiffeisen Bank”.

¹⁴E ardhur *neto* është konsideruar diferenca midis të ardhurave me shpenzimet.

¹⁵“Raiffesisen Bank”, 547.000 lekë nga llogaria e pagës së subjektit dhe 540.000 nga ajo e bashkëshortit.

¹⁶“Raiffeisen Bank”, 1.003.500 lekë nga llogaria e pagës së subjektit dhe 822,000 lekë nga ajo e bashkëshortit

¹⁷“Raiffeisen Bank”, 148,000 lekë nga llogaria e subjektit dhe 159,000 lekë nga ajo e bashkëshortit.

subjekti argumenton se për sa kohë në kontratën e sipërmarrjes nuk përcaktohet specifikisht mënyra dhe koha e likuidimit të çmimit, referimi në këto fakte duhet të jetë objektiv.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni i vlerëson bindëse argumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi kontrata e sipërmarrjes me datë 19.2.2009, parashikon se *çmimi i apartamentit objekt i kësaj kontrate sipërmarrje do të jetë 25.219 euro, shumë kjo e cila është likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale*, pa u përcaktuar data e lidhjes së kontratës si moment deciziv i likuidimit tërësor ose pjesor të kësaj shume. Ndërsa, nga verifikimi i tre kontratave të ngjashme të përmendura nga subjekti me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k., konstatohet se:

- (i) në kontratën nr. ***, datë 11.4.2007, parashikohet se *çmimi i apartamentit është në vlerën 42.456 euro dhe pala porositëse do të paguaje sot me nënshkrimin e kontratës 22.456 euro, kurse pjesa tjetër e mbetur prej 20.000 euro do të merret kredi në bankë;*
- (ii) në kontratën nr. ***, datë 26.1.2007, parashikohet se *çmimi në shumën 48.000 euro do të paguhet totalisht sot me nënshkrimin e kontratës;*
- (iii) në kontratën nr. ***, datë 9.6.2009, parashikohet se *çmimi total do të jetë në vlerën 23.360 euro, shumë për të cilën palët deklarojnë se është likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre me noterizimin e kësaj kontrate.*

Siç vërehet, në të tria rastet, pagesa tërësisht ose pjesërisht e çmimit të shitjes, ka ndodhur në momentin e lidhjes së kontratës, duke u shprehur specifikisht ky fakt. Ndërsa në rastin e kontratës së sipërmarrjes së subjektit, në asnjë moment nuk parashikohet që likuidimi i çmimit të shitjes apo një pjesë të tij, të jetë kryer në ditën e nënshkrimit të kontratës. Në rast se kjo do të kishte ndodhur, do të parashikohej në kontratë, ashtu sikurse ka ndodhur në tre rastet e sipërpërmendura. Në kontratën e sipërmarrjes lidhur në datën 19.2.2009 me bashkëshortin e subjektit, kuptohet qartazi dhe konfirmohet se likuidimi tërësor i çmimit të shitjes së pasurisë ka përfunduar me nënshkrimin e kontratës, por jo në momentin e nënshkrimit të kontratës. Këtë fakt ka konfirmuar dhe shoqëria ndërtimore në deklaratën noteriale nr. 985/397, datë 4.4.2020, sipas të cilës, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, z. G. N. e ka likuiduar tërësisht çmimin e shitblerjes së apartamentit prej 25.219 euro dhe se nuk ka asnjë detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. Ndërkohë që me shkresën datë 2.9.2020, shoqëria ka konfirmuar se z. G. N., ka kryer pagesat në katër këste gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, sipas katër mandatarkëtimeve të vëna në dispozicion të Komisionit.

Së pesti, në lidhje me vërtetësinë e katër mandatarkëtimeve *dublikate* për pagesat e kryera në vitet 2007, 2008 dhe 2009, subjekti ka deklaruar se përgjigjet e administruara nga shoqëria “****” sh.p.k., provojnë pagesat e kryera dhe kohën e saktë të kryerjes së tyre. Duke parashtruar se këto fakte janë pohuar prej saj në komunikimin gjatë hetimit administrativ, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit vendimin e formës së prerë nr. 242/2020 në të cilin theksohet: *“Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në këtë rast, duke u konsideruar si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrin vlerë provuese të rëndësishme, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat e informacionet rreth këtij fakti, që japin aktet e sipërcituara, të paraqitura prej subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe që konsiderohen prova, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.*

Bashkëngjitur parashtrimeve, subjekti ka vënë në dispozicion:

- shkresën kthim-përgjigje, datë 2.9.2020, të shoqërisë “****” sh.p.k. drejtuar z. G. N., bashkëngjitur lista e klientëve të shoqërisë në të cilën figuron edhe emri i tij si klient dhe pagesat e kryera në vitet 2007, 2008 dhe 2009, në total 25.219 euro;

- bilancin e vitit 2007 të shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilin nuk ka të dhëna analitike mbi pagesat e kryera nga klientë të shoqërisë, për rrjedhojë, nuk mund të evidentohen pagesa të kryera nga z. G. N.;
- dy kërkesa drejtuar DRT-së Tiranë me datë 12.8.2020 dhe datë 31.8.2020, nëpërmjet të cilave është kërkuar informacion si: bilancet kontabël; pasqyrat financiare me shënimet shpjeguese; raporte të ekspertëve kontabël (nëse ka) për periudhën 2007, 2008 dhe 2009; raporte kontrolli që përfshijnë këto bilance/pasqyra financiare; si dhe dokumentacionin pjesë të dosjes së kontrollit tatimor, librat e shitjes si dhe formularët e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së për këtë periudhë;
- shkresën nr. ***, datë 8.9.2020, të DRT-së Tiranë sipas të cilës informacioni i kërkuar nuk mund t’i vihet në dispozicion.

Për sa më sipër, vërehet se subjekti nga njëra anë sjell në vëmendje se gjatë procesit të rivlerësimit ka paraqitur prova për të vërtetuar pagesat e kryera gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, dhe nga ana tjetër, ka vërtetuar se sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ka bërë përpjekje për të provuar vërtetësinë e katër mandatpagesave *dublikate*, por nuk ka mundur të sigurojë informacion nga DRT-ja, sipas kërkesës së bërë.

Me qëllim krijimin e bindjes për sa i takon origjinalitetit të mandatpagesave *dublikatë* që shoqëria ka vënë në dispozicion, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion të detajuar nga DPT-ja Tirane për shoqërinë “****” sh.p.k., e cila me shkresën nr. ***, datë 20.8.2020, ka vënë në dispozicion:

- të ardhurat e realizuara nga shoqëria sipas deklaratave vjetore të tatim fitimit për vitet 2007 – 2009;
- bilancet dhe pasqyrat financiare të shoqërisë për vitet 2007 – 2009;
- formularët e deklarimit të TVSH-së për vitet 2007 – 2009 për vitet 2007 – 2009;
- raportet e ekspertëve kontabël për vitet 2007 – 2009, si dhe sigurime shoqërore e shëndetsore 07/2008 – 01/2009;
- akti i kontrollit nr. *** prot., datë 24.3.2011, i cili tregon se është kryer kontroll nga organet tatimore për TVSH, për periudhën 07/2008 – 01/2011; për tatim fitimin për periudhën 2008 – 2009; për pagesën e sigurimeve shoqërore për periudhën 07/2008 – 01/2011.

Nga verifikimi i këtyre dokumenteve, konstatohet se shoqëria ka pasur qarkullim në vlera të konsiderueshme në vitet 2007 – 2009 dhe se bilancet e shoqërisë për këtë periudhë, shërbejnë si tregues që shoqëria ka regjistruar arkëtimet e pritshme nga klientët e saj, por nuk pasqyrojnë të dhëna analitike mbi arkëtime nga klientët¹⁸. Edhe nga akti i kontrollit të kryer nga organet tatimore, nuk mund të evidentohen të dhëna analitike, pra, pagesa specifike të kryera nga blerësa të pasurive.

Arsyetim ligjor

Në vlerësimin tërësor të rrethanave të përshkruara në mënyrë të detajuar si më sipër në këtë vendim, si dhe referuar faktit që kontrata e sipërmarrjes, datë 19.02.2009, nuk vërteton likuidimin e çmimit të shitjes pikërisht në këtë datë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi si provë shkresore me vlerë të plotë ligjore shkresën kthim-përgjigje të datës 23.7.2020 të shoqërisë “****” sh.p.k., shkresë e cila ka elementët një dokumenti zyrtar, redaktuar, nënshkruar dhe vulosur nga administratori i shoqërisë, z. R. Z.

Sipas ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, shoqëritë tregëtare kanë një afat 10-vjeçar për ruajtjen e librave të shitjes e faturave tatimore të shitjes,

¹⁸Në këto bilance, pikërisht te pasqyra e pasivit, janë të regjistruara në total shuma të cilat tregojnë arkëtimet e kryera nga klientët për porositë/prenotimet e apartamenteve të bëra prej tyre. Në bilancet përkatëse të viteve 2007 dhe 2008, zëri “Shuma të arkëtuara me porosi” është shumë herë më i lartë se shuma e paguar nga subjekti.

afat i cili ka përfunduar. Në këto kushte, listëpagesat e mbajtura në një regjistër elektronik nga ana e shoqërisë ndërtimore me emra të porositësave për blerjen e pasurive (njëri prej të cilëve është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), me të dhëna që vërtetojnë datat dhe pagesat përkatëse nga klientët, si dhe lëshimi i mandateve *dublikatë* në mungesë të madatave origjinale, nuk mund të çmohet nga Komisioni një “gabim”, dhe për më tepër një listë e përpiluar sot për efekt të procesit të rivlerësimit.

Veç sa me sipër, për sa kohë administratori i shoqërisë ka deklaruar dhe konfirmuar pagesat e kësteve në vitet 2007, 2008 dhe 2009 në shuma të mirëpërcaktuara e me përshkrimin përkatës, duke vënë në dispozicion mandatpagesa me numra e data logjikisht të sakta, si dhe në kushtet kur nuk u administrua asnjë fakt dhe e dhënë nga cilido burim qoftë, që të vijë në kundërshtim apo të vëjë në dyshim vërtetësinë e informacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k., Komisioni, jo vetëm që nuk gjeti shkak, por vlerëson se nuk ka asnjë targer ligjore që të konsiderojë se këto të dhëna përmbajnë fakte të pavërteta e që vijnë në kundërshtim me realitetin.

Në të kundërt, do të veprohej në kundërshtim me parimin e objektivitetit¹⁹, duke shkelur të drejtat e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor rivlerësimi, proces i cili është në vetvete një proces administrativ, gjatë të cilit, subjektet e rivlerësimit kanë të drejta të rregulluara nga Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë (nenet 35 - 40 dhe 45 - 47). Në ushtrim të të drejtave që përcakton neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtën të paraqesin mendime dhe shpjegime për fakte, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes, subjekti arriti të vërtetojë bindshëm se edhe pse nuk ka pasur një marrëveshje me shkrim midis palëve përpara vitit 2009, bashkëshorti i saj ka kryer pagesat në favor të shoqërisë ndërtimore në vitet 2007, 2008 dhe 2009, me të ardhurat e tyre nga pagat, sipas katër mandatpagesave të vëna në dispozicion nga shoqëria, pagesa për të cilat u vërtetua të jenë kryer tërheqje vlerash monetare nga llogaritë bankare të pagave, përpara kryerjes së tyre. Në këtë mënyrë, u vërtetua plotësisht se midis palëve ka ekzistuar një marrëveshje e pamaterializuar në formë shkresore që në vitin 2007 (për të cilën ligji nuk parashikon ndonjë detyrim ose ndalesë ligjore), marrëveshje e cila vijoi me kontratën e sipërmarjes me datë 19.2.2009, duke u finalizuar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 1.12.2010.

Është e vërtetë që subjekti nuk ka deklaruar pagesat e kryera për blerjen e pasurisë dhe pakësimin e likuiditeteve në banka për shkak të këtyre pagesave gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009²⁰, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe deklaratave të interesave private periodik/vjetore në rubrikën “ndryshimet e pasurive”. Por, Komisioni vlerëson se arsyeja e këtij mosdeklarimi ka qënë pikërisht mungesa e një marrëveshjeje të materializuar me akt shkresor midis palëve që në vitin 2007, si dhe e një objekti konkret porositjeje/shitjeje. Nga ana tjetër, është vërtetuar plotësisht se llogaritë bankare kanë qënë llogari page (për rrjedhojë pakësimet apo shtesat e tyre janë tërësisht dhe lehtësisht të verifikueshme) dhe se, likuiditetet e tyre janë përdorur për pagesën me këste të çmimit të blerjes së pasurisë gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, arsyetuar hollësisht me sipër në këtë vendim. Për më tepër, këtë arsyetim e mbështet tërësisht dhe deklarimi i bashkëshortit të subjektit në DPV për vitin 2009 në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, ku si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhura të kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Në vlerësimin e Komisionit, është e palogjikshme, që bashkëshorti i

¹⁹ Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

²⁰ Në DPV/2009, subjekti ka deklaruar pasurinë por jo ndonjë pagesë të kryer.

subjektit të ketë deklaruar si burim krijimi të pasurisë vetëm të ardhurat e krijuara nga pagat për periudhën 01.01.2009 deri në 10.02.2009, kur është lidhur kontrata e sipërmarjes.

Është e vërtetë se si Kushtetuta në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të Aneksit të saj, ashtu dhe ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit. Por, sipas këtyre dispozitave ligjore, verifikimi dhe evidentimi i pasaktësive në këto deklarime bëhet me qëllim që të identifikohen subjekte me pasuri në pronësi ose në përdorim më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Në rastin konkret, është vërtetuar plotësisht se e vetmja pasuri e paluajtshme e blerë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj gjatë periudhës së rivlerësimit (por jo vetëm), është një apartament banimi me sipërfaqe prej 66.2 m², pasuri e cila u vërtetua të jetë blerë më të vetmet të ardhura me burim pagat e bashkëshortëve Ndoi dhe të deklaruara rregullisht ndër vite. Ndërsa, për sa i takon pasurive të luajtshme, u verifikua që subjekti dhe bashkëshorti i saj gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (por jo vetëm) kanë blerë tre automjete në vitet 2004, 2013 dhe 2014, përkatësisht me vlera 190.000 lekë, 100.000 lekë dhe 100.000 lekë, me të ardhura të justifikuar ligjërisht me burim pagat e tyre, deklaruar gjithashtu saktësisht ndër vite. Për më tepër, nuk rezulton asnjë e dhënë nga cilido burim i ligjshëm apo e dalë nga hetmi administrativ, se subjekti ka përdorur likuiditetet në banka për të krijuar ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë shpenzim, veç atyre të deklaruara ndër vite dhe deklaraten vetting, situatë faktike e cila do të kërkonte domosdoshmërisht saktësinë e deklarimeve periodike të subjektit, sipas kërkesës së nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni çmon se pasaktësia e këtyre deklarimeve nuk afektonte verifikimin e ligjshmërisë së burimit si për pasurinë objekt shqyrtimi, ashtu edhe për të gjitha pasuritë e subjektit²¹.

Për të gjitha sa është arsyetuar më sipër, duke mos anashkaluar fuqinë provuese të deklaratave periodike sipas nenit 32/5 të ligjit nr.84.2016, pasaktësitë në deklarime për shkak të mosdeklarimit të pakësimit të likuiditeteve në banka me të cilat subjekti ka kryer pagesat për shoqërinë ndërtimore gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, dhe të cilat, përtej çdo dyshimi u provuan se janë krijuar me të ardhura të ligjshme, u çmuan nga Komisioni si formale dhe që në raport me deklaratën vetting dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen të pamjaftueshme për një vlerësim negativ të kriterit të pasurisë, e për rrjedhojë, nuk kanë sjellë pasojat e një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuadër të parashikimeve të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, sa i takon pasurisë objekt shqyrtimi me nr. ***, apartament banimi me sip. 66.2 m², Komisioni krijoi bindjen se pagesa e çmimit të shitjes prej 25.219 euro është kryer gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009 me të ardhura kursimet nga pagat e bashkëshortëve Ndoi, ashtu sikurse është deklaruar në deklaratën për vitin 2009 nga bashkëshorti i subjektit dhe në atë *Vetting* nga subjekti, sipas datave dhe shumave pasqyruar në mandatarkëtimet e vëna në dispozicion nga shoqëria ndërtimore. Për rrjedhojë, shuma prej 3.137.611 lekësh/25.219 euro, e cila gjatë hetimeve paraprake ishte konsideruar si e paguar tërësisht në datën 19.2.2009, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, u konsiderua e paguar me këste në datat 2.5.2007, 26.12.2007, 12.11.2008 dhe 19.2.2009, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

<i>Përshkrimi</i>	<i>2.5.2007</i>	<i>26.12.2007</i>	<i>12.11.2008</i>	<i>19.2.2009</i>
Pasuri	142,116	615,141	631,707	240,288

²¹ Shih vendimin e KPA (JR) Nr. 28 i vendimit Datë 23.10.2020, paragrafi 2, faqe 10 e vendimit.

Apartament banimi 66.2 m ² , Farkë, Tiranë	1,263,200	602,050	1,011,841	260,520
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>-1,121,084</i>	<i>13,091</i>	<i>-380,134</i>	<i>-20,232</i>
Total likuiditete	290,189	303,280	17,589	-25,817
Të Ardhura	450,058	1,190,407	1,764,817	297,150
Të ardhura nga pagat subjekti	200,001	624,983	847,436	149,288
Te ardhura nga pagat bashkëshortja	250,057	565,424	917,381	147,862
Shpenzime	284,748	319,242	666,536	223,363
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	134,748	267,251	516,536	73,363
Shpenzime shkollimi G. N.	150,000		150,000	150,000
Shpenzime udhëtimi		51,991		
Mundësia për kursime	23,193	256,023	466,574	-166,501

Në procesin e vlerësimit përfundimtar, Komisioni vlerësoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar çmimin e shitjes së pasurisë, me përjashtim të një balance negative prej -166.501 lekësh në vitin 2009, e cila nuk u çmua si vlerë e konsiderueshme dhe shkak për penalizim të tij.

2. Kati i dytë i banesës private në lagjen nr. ***, ***, e ndërtuar nga shtetasi N. V. në vitin 1993, e pa legalizuar, prandaj nuk është bërë formalizimi i kalimit të pronësisë me dokumente ligjore, por është e njohur dhurimi vetëm me deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017. Kjo pronë është deklaruar që në deklaratën fillestare të vitit 2003 dhe burim i të ardhurave ka shërbyer biznesi i prindërve shoqëria “****” sh.p.k., Tropojë. Vlera: 4.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar: (1) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për ndërtimin e objektit të banimit 3 kate në ***, nga shtetasi N. V. (babai i subjektit); (2) mungesë burimi të ligjshëm financiar nga ana e shtetasit N. V. (babai i subjektit), pasi nga institucionet përkatëse nuk konfirmohen të ardhura nga aktiviteti privat në emër të tij dhe bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie

2.1 Në lidhje me statusin e kësaj pasurie

- ASHK-ja Kamëz, Vorë²² informoi se në emër të shtetasit N. P. V. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, objekt banimi 3 kate.

- OSHEE²³ informoi se shtetasi N. V. është abonent me kontratë furnizimi me energji ***, në instancën e Tiranës.

- Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj, pasi u kryen të gjitha verifikimet, dhe bazuar në provat e administruara²⁴, në përfundim të hetimit administrativ, u vërtetua se pasuria është përfituar në mënyrë të ligjshme nga shtetasi N. V.

2.2 Nga verifikimi i DPV, rezultoi se subjekti ka deklaruar këtë pasuri, si vijon:

- Në deklarinimin para fillimit të detyrës për vitin 2003: “*Banesë 2-katëshe, me vlerë 5.000.000 lekë, ***, ***, Tiranë. Burimi i krijimit: kursime familjare nga shitja e një banese në Barjam Curri e përfituar me ligjin e privatizimit*”.

²²Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.12.2019, nga ASHK Kamëz, Vorë në dosjen e Komisionit.

²³Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE në dosjen e Komisionit.

²⁴Shih aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI dhe shkresën kthim-përgjigje Nr.*** Prot, dt.23.12.2019 nga ASHK Kamëz Vorë në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-në e vitit 2004: *“Shtëpi banimi ndërtuar në vitin 1993, në *** e palegalizuar me sip. 130 m2, kati i dytë. Vlera: 4.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Viti i krijimit 1993”*.
- Në deklaratën *Vetting*, si në pikën 2 më sipër.

Siç vërehet nga këto deklarime, rezultoi se:

(i) Ka mospërputhje të deklarimeve lidhur me vlerën e deklaruar të pasurisë, pasi në DPV-në e vitit 2003 vlera deklarohet 5.000.000 lekë, ndërsa në DPV-në e vitit 2004 dhe deklaratën *Vetting*, vlera deklarohet 4.500.000 lekë. Në lidhje me këtë mospërputhje, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjektika deklaruar se: *... prindërit e saj nuk kanë mbajtur dhe nuk kanë ruajtur dokumentacion mbi vlerën e investimit, dhe për këtë arsye në deklaratat fillestare të pasurisë, atë të vitit 2003 dhe më vonë të vitit 2004, ajo ka deklaruar vlerën e tregut sipas një vlerësimi subjektiv dhe të përafërt, dhe jo vlerën të cilën prindrit kanë shpenzuar për ta ndërtuar, sepse këtë vlerë nuk e dinë as ata...*

(ii) Ka mospërputhje të deklarimeve lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, pasi në deklaratën për vitin 2003, si burim deklarohet shitja e një banese në Barjam Curri e përfituar me ligjin e privatizimit, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarohen të ardhurat nga biznesi i prindërve nga shoqëria “***” sh.p.k., Tropojë. Ndërsa, gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, janë deklaruar të ardhurat nga të dyja këto burime.

Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto mospërputhje. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar: *“... siç është provuar edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, kjo banesë ka filluar të ndërtohet në vitin 1993 kur unë kam qenë vetëm 16 vjeç.Sigurisht që unë edhe për shkak të moshës, por dhe angazhimeve të mia shkollore nuk jam marrë fare me aspektin financiar të familjes time. Por e di me saktësi që, prindërit e mi filluan të ushtronin aktivitet të ligjshëm tregtar që në vitin 1991. Babai përveç kësaj, punonte në forcat vullnetare si ushtarak. Siç rezulton nga provat e administruara gjatë hetimit, prindërit, përveç fitimit të realizuar nga aktiviteti tregtar i shitblerjes, merrnin edhe pagë. Me pas në vitin 1995 është shitur dhe apartamenti në Bajram Curri dhe këto të ardhura kanë qenë pjesë e buxhetit familjar të përdorur për krijimin e pasurisë. I rëndësishëm është fakti që prindërit e mi e kanë bërë ndërtesën mbi një punë stërmunduese (kanë marrë pjesë vetë fizikisht në ndërtimin e saj) por mbi të gjitha, me të ardhura që buronin nga puna tyre e ligjshme ...”*.

Në përfundim, Komisioni i vlerësoi bindëse argumentet e subjektit te rivlerësimit, se mospërputhjet në deklarime kanë ardhur si pasojë pamundësisë për të evidentuar ekzaktësisht të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj pasurie nga prindërit, për shkak të moshës së re të subjektit dhe kohës së hershme të ndërtimit të objektit (8-10 vjet nga momenti i deklarimit të parë dhe gati 25 vjet nga deklarata *Vetting*), si dhe mungesës totale të lidhjeve të tij me këtë pasuri.

2.3 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë dhe analizën financiare

Edhe pse pasuria objekt shqyrtimi nuk është investuar prej znj. Afërdita Ndoi e cila ka qenë vetëm 16 vjeç në kohën e fillimit të punimeve, Komisioni ka verifikuar të dyja burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie në pronësi të personit tjetër të lidhur, duke vlerësuar si periudhë të kryerjes së punimeve, periudhën 1993 – 1995, referuar provave si vijojnë:

- (i) vetëdeklarim për legalizim i datës 20.3.2005 për legalizimin e një shtëpie 2-katëshe në lagjen ***, Tiranë, sipas të cilës periudhë ndërtimi është deklaruar data 8.8.1993;
- (ii) DPV-në e vitit 2003, ku subjekti ka deklaruar si burim krijimi edhe shitjen e një banese në vitin 1995;
- (iii) DPV-në e vitit 2004, ku si vit ndërtimi i katit të dytë është deklaruar viti 1993;

(iv) deklaramet gjatë procesit të rivlerësimit: "...ndërtesa si karabina (dy kate) është ndërtuar që në vitin 1993, por rifiniturat në katin e 2-të të ndërtesës (suvatime, pllaka, dyer e dritare) janë kryer deri në vitin 1995, vit në të cilin kati i 2-të i ndërtesës ka përfunduar plotësisht, dhe në këtë vit, pra në 1995 familja e prindërve përveç të ardhurave nga aktiviteti i shoqërisë "****" shpk ka realizuar të ardhura edhe nga shitja e banesës së rivatizuar në Tropojë...".

Në lidhje me të ardhura të shoqërisë "****" sh.p.k., nga verifikimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja²⁵ dhe nga ato të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit²⁶, u konstatua se:

(i) subjekti "****" sh.p.k., me administrator fillimisht B. V., nëna e subjektit, i ka kaluar me dhurim shtetasit N. V., babai i subjektit, i cili rezultoi në regjistruar pranë DRT-së Tiranë si subjekt me aktivitet transport udhëtarësh (8+1) vende;

(ii) qarkullimi total për vitet 1998, 1999 dhe 2000 të shoqërisë "****" sh.p.k., është 6.000.000 lekë.

(iii) Drejtorja Tatimore Kukës, me shkresën nr. ***, datë 31.3.2020, informon se nuk ka dokumente për këtë subjekt për vitet 1993-1995, pasi informacioni i përket një periudhë të hershme kohore. Pavarësisht këtij fakti, referuar procesverbalit të datës 19.7.1994, të Drejtorisë Tatimore Tropojë për pagesën e tatimit mbi xhiron për vitin 1993 dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së dhe mandatpageve të tatimit për vitet 1994 dhe 1995 të vëna në dispozicion nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, si dhe bazuar në ligjin nr. 7679, datë 3.3.1993, për tatimin mbi biznesin e vogël të aktivitetit tregtar, rezultoi që shoqëria të ketë pasur një xhiro vjetore në masën 240.000 lekë dhe një fitim mbi xhiron në vit prej 96.000 lekësh (sipas marzhit të fitimit 40 %, duke pasur parasysh që biznesi është familjar dhe dyqani në pronësi, pa qera). Për rrjedhojë, për vitet 1993 – 1995, në total, biznesi "****" sh.p.k., u vlerësua të ketë pasur një fitim prej 288.000 lekësh.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e një banese në Barjam Curri, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka vënë në dispozicion kontratën Nr. ***, datë 21.7.1995, e cila vërteton të ardhura nga shitja në shumën 400.000 lekë. Për sa i takon pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja, subjekti vertetoi mungesën e pagimit për shkak se tatimi për kalimin e pronësisë së paluajtshme ka nisur të aplikohet në vitin 1998, me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat"²⁷.

Sa më sipër, në total, të ardhurat e familjes Vatnikaj për vitet 1993 – 1995, janë vlerësuar në shumën 688.000 lekë.

Sa i takon vlerës së investimit në objekt, pavarësisht deklarimeve të subjektit në shumat prej 5.000.000 lekë dhe 4.500.000 lekë, përkatësisht në deklaratën për vitin 2003 dhe deklaratën vetting (sipas një vlerësimi subjektiv dhe të përafërt të vlerës së tregut në mungesë të dokumentacionit vërtetues), gjatë procesit, subjekti ka vënë në dispozicion një raport vlerësimi²⁸ sipas të cilit kjo vlerë është 717.273 lekë, ku vërehet se përlllogaritjet e volumeve për zërat ndërtimore, janë marrë nga matjet e një ndërtimi i cili ka qënë informal, pa u bazuar në asnjë dokument shkresor. Po kështu, me kërkesë të Komisionit, ASHK-ja²⁹ vuri në dispozicion praktikën e plotë të legalizmit të sipërfaqes totale të ndërtimit për banim 498.2 m², objekt me 3 kate, pa vënë në dispozicion asnjë të dhënë në lidhje me investimeve në objekt.

²⁵Shih aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶Shih dokumentet bashkëngjitur në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

²⁷ Shih shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2020, nga DPT dërguar elektronikisht në datën 22.5.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁸Shih Raport Vlerësimi bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 dërguar nga subjekti në datën 6.4.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.5.2020, nga ASHK Kamëz- Vorë, në dosjen e Komisionit.

Në këto kushte, nga ana e Komisionit, janë kryer përlllogaritjet sipas çmimeve reference të EKB-së. Nisur nga fakti se për vitet 1993 – 1995, nuk ka të dhëna të publikuara mbi çmimet reference të EKB-së, Komisioni iu referua vendimit nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 1995”. Sipas kësaj referencë, për qytetin e Tiranës, kosto mesatare e ndërtimit ishte 12.883 lekë/m² dhe ndërtimi i katit të dytë të banesës 3-katëshe do të kushtonte $136.3 \text{ m}^2 \times 12.883 \text{ m}^2 = 1.755.953$ lekë.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i është bërë me dije se të ardhurat e familjes prindërore në vitet 1993 – 1995, në shumën prej 688.000 lekësh, duket se janë të pamjaftueshme për investimin në katin e dytë të objektit nga zoti Vatnikaj, duke iu dhënë mundësia për të dhënë sqarime të mëtejshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo pasuri nuk duhet të ishte objekt i hetimit administrativ, duke renditur shkaqe si vijojnë: (1) pasuria është ndërtuar në vitet 1993-95, kohë në të cilën ishte e mitur; (2) nuk ka kontribuar në asnjë mënyrë në ndërtimin e saj; (3) nga kjo pasuri nuk ka rrjedhur asnjë lloj përfitimi, as para dhe as pas marrjes së detyrës si prokurore, përveçse një deklaratë noteriale që babai i saj ka bërë për të shpjeguar faktin që ka ndërtuar një objekt dhe qëllimi i ndërtimit të katit të dytë ka qenë për vajzën e tij; (4) kalimi i kësaj pronë në favor të saj nuk gjen vullnet të shprehur në asnjë lloj forme ligjore për kalimin e pronësisë (kontratë dhurimi, shitje apo çdo lloj forme tjetër të parashikuar në ligj). Edhe pas vullnetit të shprehur të babait të saj në vitin 2017, kjo pasuri është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë në vitin 2019 vetëm në emër të babait dhe vazhdon të jetë në emër të tij, çka sipas saj, tregon që nuk gëzon realisht asnjë lloj të drejtë mbi të.

Veç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të KPA-së, i cili sipas saj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim të pretenduar prej subjektit, për personat e tjerë të lidhur.

Përkundër sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se shtetasi Ndue Vatnikaj është person tjetër i lidhur sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, referuar: (i) deklaratimit të shtetasit N. V. se kati i dytë i këtij objekti është ndërtuar për vajzën, znj. Afërdita Vatnikaj Ndoi; (ii) deklarimeve në lidhje me këtë pasuri në deklaratat për vitet 2003 dhe 2004; (iii) deklaratës *Vetting* ku subjekti ka deklaruar katin e dytë të pasurisë; (iv) DPFID të vitit 2003, ku subjekti ka deklaruar një automjet në vlerën 400.000 lekë me të ardhura të dhuruara nga babai i saj, z. N. V.

Për sa i takon konstatimit se të ardhurat e familjes së saj prindërore në vitet 1993 – 1995, në shumën prej 688.000 lekësh, duket se janë të pamjaftueshme për investimin në katin e dytë të objektit, në parashtrimet e veta, subjekti ka sqaruar se ky konkluzion është i gabuar, jo vetëm në përlllogaritjen e të ardhurave të realizuara nga prinderit e saj në fund të vitit 1995, por edhe në drejtim të metodologjisë së përdorur për përcaktimin e vlerës së katit të dytë të banesës objekt hetimi. Më tej, ka deklaruar se gjatë hetimit administrativ ka paraqitur në Komision çdo dokument që ka mundur të gjejë babai i saj, duke menduar që pas 25 apo 30 viteve nuk ka qënë e nevojshme ruajtja e tyre. Nga ana tjetër, subjekti thekson faktin se legjislacioni tatimor detyron subjektet tatimore ta ruajnë këtë dokumentacion për 5 vite, ndërsa ligji i kontabilitetit kërkon nga subjektet t'i ruajnë të dhënat kontabël deri në 10 vjet. Sipas saj, në kushtet kur dokumentacioni nuk është i plotë, është e pamundur të përcaktohet saktësisht vlera e fitimit *neto* të realizuar nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “***” sh.p.k.. për vitet 1991 – 1995.

Për të vërtetuar pretendimet, subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresorë, nga verifikimi i të cilave, u konstatua se informacioni është original dhe i kohës, fakt që të krijon bindjen se vlerat e xhiros së realizuar, ballafaquar me disa mandatpagesa tatimesh, janë të

përafërta me realitetin. Nga ana tjetër, në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion dokumentacion të plotë për pagesat e detyrimeve tatimore, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi dhe vlerësoi pozitivisht përpjekjet e subjektit, i cili ka ezauruar çdo mundësi që ligji i lejon për të vërtetuar të ardhura nga aktiviteti privat i prindërve për periudhën 1992 – 1995.

Për të gjitha arsyet e sipërpërmëndura, në përfundim të procesit, Komisioni mori të mirëqenë dhe pranoi se fitimi neto i pretenduar prej subjektit, i cili ka aplikuar saktësisht legjislacionin tatimor të kohës dhe metodologjinë analoge, për periudhën 1992 – 1995, bazuar në dokumentet që ka arritur të sigurojë, është përafërsisht në vlerën 1.837.600 lekë. Kjo shumë së bashku me të ardhurat nga shitja e pasurisë në Barjam Curri në shumën prej 400.000 lekësh, prezumohet nga Komisioni se është e mjaftueshme për investimin në katin e dytë të objektit.

Veç sa më sipër, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni vlerësoi të bazuara argumentet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me mungesën e çdo lloj lidhjeje të saj me pasurinë objekt shqyrtimi dhe ndërtimin e saj. Referuar faktit se në fillimet e ndërtimit të kësaj pasurie, subjekti ka qenë vetëm 16 vjeç, ndërsa me përfundimin e objektit ka qenë 18 vjeç, si dhe duke mosanashkuar faktin që prindërit e subjektit nuk qenë subjekte deklarues dhe si të tillë, nuk kanë pasur detyrimin për të ruajtur e vërtetuar me dokumente investimet e kryera në objekt apo burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit, Komisioni nuk evidentoi asnjë lidhje shkaksore ndërmjet ndonjë veprimi a mosveprimi të subjektit me mundësinë financiare të prindërve të saj për të kryer investimin në objekt.

Për rrjedhojë, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni nuk gjeti asnjë shkak ligjor e arsye objektive për penalizim të subjektit të rivlerësimit, për aq sa ka rezultuar në lidhje me pasurinë në pronësi të babait të subjektit, z. N. V., me adresë në ***, Tiranë, ndërtuar prej tij, rreth dhjetë vite përpara periudhës së rivlerësimit.

3. Autoveturë tip “Opel Corsa”, targa * (me dokumente italiane dhe doganë të paguar). Blerë në vitin 2013 sipas kontratës nr. ***, datë 7.10.2013. Vlera: 100.000 lekë. Burimi: kursime nga paga. Pjesa takuese: 100 %.**

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.

DPSHTRR nuk e konfirmon mjetin pasi nuk është i regjistruar dhe është me targa italiane.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se DPSHTRR-ja³⁰ nuk konfirmoi automjetin me targa *** të regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Në lidhje me këtë fakt, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se: “... ky automjet nuk është regjistruar pranë DRSHTRR-së, pasi pak kohë pas blerjes së tij, ai dha një defekt, riparimi i të cilit kushtonte afërsisht sa gjysma e vlerës së makinës (e cila ishte e vjetër prodhim i vitit 1996) dhe mundësia e defekteve të tjera ishte e madhe, e për këtë arsye mjeti nuk u përdor e nuk u regjistrua, por u shit në një pikë skrapi...”.

3.1 Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit, nuk u konstatuan problematika pasi nga aktet në dosje³¹ rezultoi se:

- sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, rezulton se automjeti i tipit “Opel Corsa”, me nr. shasie ***, figuron në pronësi të shtetasit K. L.;

³⁰Shih shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 25.12.2019 dhe shkresë nr. *** prot., datë 27.2.2019 nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

³¹Shih aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

- sipas deklaratës doganore të datës 17.4.2012, është bërë zhdoganimi i mjetit në vlerën 24.964 lekë nga shtetasi K. L.;
- me kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 7.10.2013, blerësi G. N. ka blerë nga shitësi K. L., autoveturë tip “Opel Corsa” me targa *** dhe shasi *** në çmimin 100.000 lekë, të cilën e ka shlyer totalisht. Subjekti e ka deklaruar këtë mjet në DPV-në e vitit 2013.

3.2 Në lidhje me burimin e krijimit

Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të mjetit në DPV-në e vitit 2013, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga. Nga analiza e deklarimeve të subjektit dhe dokumentave shkresore të administruara, është konstatuar se deri në datën 31.12.2012, subjekti ka pasur likuiditete të deklaruara *cash* dhe në banka në total në vlerën 1.091.079 lekë. Këto likuiditete janë krijuar me të ardhura të ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit. Në tabelën më poshte, është pasqyruar mundësia financiare e subjektit për blerjen e mjetit me të ardhura të ligjshme në datën 7.10.2013.

<i>Përshkrimi</i>	<i>7.10.2013</i>
PASURI	384,149
Automjet tip “Opel Corsa”	100,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>284,149</i>
Total likuiditete	1,375,228
TË ARDHURA	1,620,792
Të ardhura nga pagat subjekti	695,641
Te ardhura nga pagat bashkëshortja	925,151
SHPENZIME	525,605
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	423,072
Shpenzime udhëtimi	102,533
Mundësia për kursime	711,038

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika e dyshime në lidhje me këtë pasuri. Për sa i takon mosdeklarimit të burimit të krijimit të mjetit në DPV-në e vitit 2013, në kushtet kur u vërtetua se si burim i shumës prej 100.000 lekësh kanë qënë të ardhurat nga pagat, Komisioni e çmoi pasaktësinë në deklaram të tipit formal dhe që nuk ka sjellë pasojë.

4. Automjet tip “Volkswagen Polo”, me targa *, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.3.2012. Burimi i krijimit: kursime nga pagat. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar se konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRr-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie

Me kërkesë të Komisionit, DPSHTRr-ja³² konfirmoi se:

- shtetasit Afërdita Ndoi dhe G. N. kanë pasur në pronësi automjetin me targa ***, shitur më 28.12.2018, me kontratë shitjeje nr. ***, në vlerën 80.000 lekë;
- automjeti, që ka qënë me targa ***, është blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.3.2012, prej shoqërisë “****” sh.p.k., në vlerën 100.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

³² Shih aktet në aneksin 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresat nr. *** prot., datë 27.2.2019, nga DPSHTRr-ja dhe nr. *** prot., datë 25.12.2019 në dosjen e Komisionit.

4.1 Në lidhje me burimin e krijimit

Subjekti e ka deklaruar automjetin në DPV-në e vitit 2012, por pa deklaruar burimin e krijimit, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim kursimet nga pagat. Nga analiza e deklarimeve të subjektit dhe dokumenteve shkresore të administruara, është konstatuar se deri më 31.12.2011 subjekti ka pasur likuiditete të deklaruara *cash* në vlerën 744.987 lekë (nuk ka pasur likuiditete në banka). Këto likuiditete janë krijuar me të ardhura të ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit të saj. Në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Volkswagen” në shumën 100.000 lekë në mars të vitit 2012, pasqyruar në tabelën, si vijon:

Përshkrimi	6.3.2012
PASURI	301,227
Automjet tip “Volkswagen”	100,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	201,227
Total likuiditete	946,213
TË ARDHURA	436,528
Të ardhura nga pagat sr	240,979
Të ardhura nga pagat bsh	195,549
SHPENZIME	97,363
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	93,032
Shpenzime udhëtimi	4,331
Mundësia për kursime	37,938

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri. Për sa i takon mosdeklarimit të burimit të krijimit të automjetit në DPV-në për vitin 2012, në kushtet kur u vërtetua se si burim i shumës prej 100.000 lekësh kanë qenë të ardhurat nga pagat, Komisioni e çmoi pasaktësinë në deklaram të tipit formal dhe që nuk ka sjellë pasoja.

5. Gjendje e llogarisë së pagës së znj. Afërdita Ndoi në “Credins Bank”, më 26.1.2017, në vlerën 1.489.913 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Kjo llogari u konfirmua me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2019, të kësaj banke.

6. Gjendje e llogarisë *cash* – 7.100 euro, 1.600 USD, 630 GBP. Pjesa takuese: 100 %, referuar kursit të këmbimit llogaria *cash* e cila konvertohet në vlerën 1.216.174 lekë.

Nga analiza financiare e periudhës 2010 deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të krijojnë këto likuiditete në shumën 1.216.174 lekë, pasqyruar në tabelën, si vijon:

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	27.1.2017
PASURI	145,648	440,964	446,092	449,875	521,523	885,749	353,683	8,278
Automjet tip “Benz”		-190,000						
Automjet tip “Volkswagen”			100,000					
Automjet tip “Opel Corsa”				100,000				
<i>Ndryshim likuiditete</i>	<i>145,648</i>	<i>630,964</i>	<i>346,092</i>	<i>349,875</i>	<i>521,523</i>	<i>885,749</i>	<i>353,683</i>	<i>8,278</i>
Total likuiditete	114,023	744,987	1,091,079	1,440,954	1,962,477	2,848,226	3,201,909	3,210,187

TË ARDHURA	1,864,864	1,721,072	1,899,392	2,083,127	2,491,710	2,902,031	3,494,241	141,652
Nga pagat subjekti	955,646	935,556	1,063,393	960,787	1,223,449	1,211,060	1,256,358	96,512
Nga pagat bashkëshorti	909,218	785,516	835,999	1,122,340	1,268,261	1,690,971	2,210,883	45,140
Djali nga shkolla							27,000	
SHPENZIME	1,510,614	561,471	667,725	686,118	1,383,404	1,235,578	1,446,278	88,340
Shpenzime jetese	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	64,409
Shpenzime arredimi	850,000							
Shpenzime pushimesh					462,363	295,948	453,155	23,931
Shpenzime udhëtimi	114,134	14,991	109,533	122,022	41,049	42,526	52,755	
Mundësia për kursime	208,602	718,637	785,575	947,134	586,783	780,704	1,694,280	45,034

7. Gjendje e llogarisë së pagës së z. G. N. në bankën “Societe Generale Albania”, datë 26.1.2017, në vlerën 286.157 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Kjo llogari u konfirmua me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2019, lëshuar nga “OTP Bank Albania”.

8. Gjendje e llogarisë së pagës së z. G. N. në “Tirana Bank”, datë 26.1.2017, në vlerën 190.943 lekë. Pjesa takuese: 100 %, konfirmuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 8.3.2019, të administruar nga banka.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur - bashkëshorti

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. G. N., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku nuk ka evidentuar nëse ka po nuk ka pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij, por ka deklaruar të njëjtat pasuri të luajtshme, të paluajtshme, si dhe të njëjtat llogari bankare me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Konstatime të tjera

Përveç verifikimit të pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni kreu hetime në lidhje me disa konstatime të rezultuara gjatë hetimit administrativ, si vijojnë:

1. Në DPV-në e vitit 2006, në rubrikën e deklaratimit të pasurive, është deklaruar: “*ProCredit Bank, 600.000 gjithsej, 300.000 të shtuara*”.

Gjatë procesit të rivlerësimit, pasi i është kërkuar të vërtetojë me dokumente bankare, gjendet e llogarisë pranë kësaj banke në vitet 2005 – 2006, në përgjigjet e datës 14.4.2020, subjekti ka deklaruar se: “... në periudhën që referon pyetja juaj, unë dhe bashkëshorti nuk kemi pasur llogari bankare në ‘Pro Kredit Bank’ dhe në vend të ‘Credins Bank’ është bërë një lapsus dhe është shënuar Procredit Bank. Në vitin 2005 kam krijuar një depozitë bankare, në ‘Credins Bank’ me nr. llogarie ***. Në vitin 2006 së bashku me bashkëshortin kemi hapur një llogari/depozitë tjetër bankare po në ‘Credins Bank’, të përbashkët me nr. llogarie *** ...”.

Për të vërtetuar këto deklarime, subjekti ka vënë në dispozicion statemente bankare lëshuar nga “Credins Bank” në datën 14.4.2020, nga verifikimi i të cilave është konstatuar se: (1) llogaria nr. ***, çelur më 21.11.2005 dhe në fund të vitit 2006 ka pasur gjendje vlerën 314.365 lekë; (2) llogaria nr. *** është çelur më 9.10.2006 dhe në fund të vitit 2006 është zero.

Pra, gjendja e llogarisë në “Credins Bank”, në fund të vitit 2006 ka qenë në shumën totale prej 314.365 lekësh dhe jo 600.000 lekë, ndërkohë që ka qenë i paqartë burimi i krijimit të derdhjeve *cash* në këto depozita. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në rastin konkret bëhet fjalë për një llogari bankare lehtësisht të verifikueshme dhe se pasaktësia në deklaratim është një gabim

njerëzor. Këto kursime kanë si burim të ardhurat nga paga e vitit 2005, paga e janarit të vitit 2006 dhe mbyllja e depozitës së kursimit në emër të bashkëshortit G. N. në “Raiffaisen Bank” në shumën 151.876 lekë. Ky pretendim i subjektit është i bazuar, pasi realisht i vetmi burim i kësaj llogarie bankare janë të ardhurat nga pagat, ndërsa pasaktësia në shkrimin e vlerës së kësaj llogarie prej 600.000 lekësh gjithsej, është një gabim material që nuk ka sjellë asnjë pasojë.

2. Në lidhje me automjetin tip “PEUGEOT” me targa ***.

Nga verifikimi i DPV-së është konstatuar se:

- në deklaratën për vitin 2003 është deklaruar “makinë e tipit ‘PEUGEOT 205’” me targa ***, me vlerë 0.4 milion lekë, me burim krijimi të ardhurat e dhuruara nga babai;
- në DPV-në për vitin 2004 është deklaruar shuma prej 250.000 lekësh *cash*, të cilat kanë ardhur nga shitja e automjetit tip “PEUGEOT” me targa ***.

Gjatë procesit të rivlerësimit, pasi i janë kërkuar kontratat e blerjes dhe shitjes së këtij automjeti, si dhe të vërtetojë me dokumente shkresore burimin e blerjes së automjetit të deklaruar në vitin 2003, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 vuri në dispozicion dokumentet, si vijojnë:

- vërtetim nr. *** prot., datë 12.3.2019, të lëshuar nga DRSHTRR-ja Tiranë, nga ku rezulton se znj. Afërdita Ndoi ka pasur në pronësi të saj automjetin me targa *** në periudhën 17.9.2001 – 20.9.2004;
- kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 17.9.2001, sipas së cilës znj. Afërdita Ndoi ka blerë nga z. E. D. automjetin tip “PEUGEOT”, nr. shasie *** me targa ***, në shumën 50.000 lekë, e cila do të paguhet *cash* jashtë zyrës noteriale;
- kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 20.9.2004, sipas së cilës rezulton se znj. Afërdita Vatnikaj i ka shitur shtetasit K.B. automjetin tip “PEUGEOT” me nr. shasie *** dhe targa ***, në shumën 200.000 lekë.

Nga përmbajtja e kontratave u konstatuan mospërputhje në vlerat e blerjes dhe shitjes së automjetit krahasuar me deklaratimet në DPV-të e viteve 2003 dhe 2004 si vijojnë: (i) në DPV-në për vitin 2003, automjeti është deklaruar me vlerë 0.4 milion lekë, ndërsa kontrata e blerjes së automjetit datë 17.9.2001, parashikon çmimin prej 50.000 lekësh; (ii) në DVP-në për vitin 2004, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit vlerën prej 250.000 lekësh, ndërsa kontrata e shitjes së automjetit datë 20.9.2004, parashikon vlerën 200.000 lekë³³.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka deklaruar se shifra e çmimit të blerjes së automjetit në kontratën e shitblerjes datë 17.9.2001 është shënuar gabim nga noteri, pasi vlera reale është ajo e deklaruar në deklaratën për vitin 2003, pra 400.000 lekë. Për të vërtetuar mundësinë financiare të babait për dhurimin e shumës prej 400.000 lekësh, subjekti vuri në dispozicion:

- shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës fitimi *neto* nga aktiviteti privat i z. N. V. për vitin 2000, është në shumën 800.000 lekë (për vitin 2001 nuk vërtetohen të ardhura);
- kontratën e shitjes së dyqanit nr. ***, datë 3.6.2000, të znj. B. V., në shumën 800.000 lekë³⁴, për të cilin është paguar tatimi mbi të ardhurat nga shitja në shumën 4.000 lekë sipas dokumentit nr. ***, datë 5.6.2000.

Bazuar në dokumentet si më sipër dhe nga analiza financiare si në tabelën më poshtë, duket se z. N. V., ka pasur mjaftueshëm të ardhura gjatë viteve 2000 dhe 2001 që justifikojnë dhurimin e shumës prej 400.000 lekësh subjektit, shumë e përdorur për blerjen e automjetit më 17.9.2001.

³³ Në analizën për vitin 2004, si e ardhur është përllogaritur vlera prej 200.000 lekësh.

³⁴ Shih kontratën në dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3.

Përshkrimi	Viti 2000 - 17.9.2001
TË ARDHURA	1,600,000
Fitimi nga aktiviteti privat N. V. e vitit 2000	800,000
Të ardhura nga shitja e dyqanit, Tropojë datë 3.6.2000	800,000
SHPENZIME	1,133,696
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së vitet 2000 -17.9.2001	729,696
Shpenzime tatimi të shitjes së dyqanit Tropojë	4,000
Dhuruar subjektit për blerjen e automjetit tip “PEUGEOT”	400,000
Mundësia për kursime	466,304

1.3 Në deklaratën për vitin 2011, nga subjekti ka deklaruar: “... një gjendje cash në shumën 850.000 lekë, nga e cila shuma prej 600.000 lekësh ka qenë me burim kursime nga paga, ndërsa shuma prej 250.000 lekësh nga shitja e një automjeti tip ‘Benz’, me dokumente italiane në pronësi të bashkëshortit G. N.. Shitja është bërë me deklaratë shitjeje pa noter, në shumën 250.000 mijë”.

Për sa i takon shumës 600.000 lekë, deklaruar me kursime nga pagat, sipas analizës financiare për vitin 2011, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi ta krijojë këtë shumë me të ardhura nga pagat.

Komisioni kreu hetime në lidhje me automjetin e deklaruar të shitur në shumën 250.000 lekë dhe administroi kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.1.2004, sipas së cilës bashkëshorti i subjektit, z. G. N., e ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz” me nr. shasie ***, me targa provizore në vlerën 190.000 lekë³⁵. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2004.

Për sa i takon mundësisë së bashkëshortit për të blerë automjetin në datën 4.1.2004, është kryer një analizë financiare si në tabelën më poshtë, për periudhën nga viti 1999³⁶ deri në fund të vitit 2003³⁷, nga e cila rezulton se z. G. N. ka pasur të ardhura nga pagat në shumën 1.260.422 lekë dhe shpenzime jetese në shumën 476.364 lekë. Siç vërehet, mundësia për kursime është 784.058 lekë, e cila është e mjaftueshme për blerjen e automjetit në vlerën 190.000 lekë në datën 4.1.2004.

G. N.	1999	2000	2001	2002	2003	Total
Të ardhurat 1999-2003	131,321	185,730	230,073	297,282	416,016	1,260,422
Shpenzimet 1999-2003	86,672	108,000	93,864	93,864	93,964	476,364
Mundësia për kursime	44,649	77,730	136,209	203,418	322,052	784,058

Për sa i takon shitjes së këtij automjeti në vitin 2011, subjekti ka paraqitur një deklaratë dore të shtetasit E. M., i cili pranon se i ka blerë shtetasit G. N. automjetin tip ‘Benz’ ngjyrë të zezë, me nr. shasie ***, me letra italiane në shumën 250.000 lekë.

³⁵ Shih shkresat e përgjigjeve të pyetësorit 3 në datën 23.2.2020, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shih vërtetimin nga ISSh-ja që ndodhet në Aneksin 4/9 të dosjes së ILDKPKI-së. Ky vërtetim përmban të dhëna mbi pagat e z. G. N. nga prilli i vitit 1999.

³⁷ Automjeti është blerë më 4.1.2004 dhe të ardhurat e përdorura janë ato të krijuara deri në fund të vitit 2003.

shkak të detyrës me pronarët e automjeteve ⁴⁰ dhe nuk rezultoi që këta shtetas të kenë qenë të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar.⁴¹

3. Në lidhje me adresat e banimit

3.1 Në DPV-të e viteve 2005 – 2007, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi apartament i ndodhur në Rr. ‘***’ në Lezhë. Gjatë procesit të rivlerësimit subjektit iu kërkuan sqarime mbi statusin me të cilin ka jetuar në këtë apartament, duke vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë përdorimin e tij (kontrata qiraje, huapërdorje etj.), si dhe shpjegime e dokumente që vërtetojnë shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar se në këtë banesë ka jetuar bazuar në kontratën e huapërdorjes me nr. ***, të datës 2.9.2005, të lidhur me shtetasin D. M., me të cilin sqaron se kanë lidhje miqësie dhe familjare si ajo ashtu edhe bashkëshorti dhe se nuk kanë pasur shpenzime për qëndrimin në këtë banesë, përveç pagesës së ujit dhe dritave. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion kontratën e huapërdorjes me nr. ***, të datës 2.9.2005.

Me kërkesë të Komisionit, SPAK-u informoi se⁴² për shtetasin D. M. nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Po kështu, nuk u vërtetua që subjekti të ketë qenë në konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrës me këtë shtetas apo me shoqërinë ‘***’ sh.p.k., administrator i së cilës është ai⁴³.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk ka pasur dyshime në lidhje me këtë adresë banimi.

3.2 Në DPV-në e vitit 2008 e në vijim deri në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile: Rr. ‘***’, p. ***, shk. ***, ap. ***, në njësinë nr. ***, Tiranë.

Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se kjo adresë është e regjistruar në gjendjen civile për efekt të regjistrimit të fëmijëve në kopshët dhe në çerdhe dhe se ata nuk kanë banuar asnjëherë atje. Kjo adresë i përkiste adresës së banimit të xhaxhait të saj N. V., i cili banonte në një zonë, ku sistemi arsimor shtetëror, në vlerësimin e tyre, ishte më i mirë. Subjekti ka sqaruar se me xhaxhanë e saj kishin lidhur një kontratë qiraje, por që nuk e kanë ruajtur. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka vënë në dispozicion⁴⁴ dokumentet si vijojnë:

- përgjigjen e Njësisë Administrative Nr. 5, ku përcillet kontrata e qirasë nr. *** rep., datë 13.2.2009;
- deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.5.2020, të shtetasës A. V. bashkëshortja e z. N. V., e cila konfirmon deklaratimet e subjektit.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka pasur dyshime në lidhje me këtë adresë banimi.

4. Gjatë hetimit administrativ u bënë kërkime në lidhje me kontrata të mundshme të subjektit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me operatorët e ofrimit të shërbimeve të internetit si TRING, Albtelecom, Abissnet, Abcom dhe me UKT-në. Sipas informacionit të vënë në

⁴⁰Shih shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 25.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 11.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 19.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

⁴¹Shih shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 30.7.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁴²Shih shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 17.4.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁴³Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 19.3.2020, lëshuar nga Prokuroria e Shkallës së Parë Lezhë dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 11.3.2020, lëshuar nga Prokuroria Shkodër.

⁴⁴Shih dokumentet dërguar elektronikisht në datën 22.5.2020, në dosjen e Komisionit.

dispozicion⁴⁵, vetëm Abcom-i konfirmoi kontratë pajtimi të komunikimeve elektronike dhe televizionit dixhital kabllor ne emër të shtetasve G. N. dhe N. V., në adresat e pasurive të vërtetuara edhe gjatë hetimit administrativ, përkatësisht *** ,dhe Kamëz Tiranë.

Analiza financiare

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizë financiare për të gjithë periudhën e vlerësimit 2003 – 2016, duke e konsideruar pagesën e çmimit të blerjes së pasurisë nr. ***, e llojit apartament banimi me sip. 66.2 m², z.k. ***, të kryer gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, përkatësisht në shumat 15.000 euro, 8.219 euro dhe 2.000 euro, prezantuar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë. Nga kjo analizë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016.

	1	2	3	4
Përshkrimi	Pasuri	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime 2-1-3
2003	200,000	680,673	93,964	386,709
2004	700,000	1,605,507	187,928	717,579
2005	326,267	1,216,803	273,893	616,643
2006	375,005	1,563,800	523,503	665,292
2007	851,701	1,826,653	611,851	363,101
2008	608,533	1,833,644	696,480	528,631
2009	234,479	2,038,168	798,284	1,005,404
2010	145,648	1,864,864	1,510,614	208,602
2011	440,964	1,721,072	561,471	718,637
2012	446,092	1,899,392	667,725	785,575
2013	449,875	2,083,127	686,118	947,134
2014	521,523	2,491,710	1,383,404	586,783
2015	885,749	2,902,031	1,235,578	780,704
2016	353,683	3,494,241	1,446,278	1,694,280
TOTAL	6,539,520	27,221,685	10,677,090	10,005,074

Metodologjia e përdorur nga Komisioni gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së tij.

⁴⁵Shih shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datën 16.7.2020 nga Tring; shkresë kthim-përgjigje nr. *** , datë 16.7.2020, nga Albtelecom; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 6.7.2020, nga Abissnet; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 8.7.2020, nga Abcom dhe shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.7.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

- Të ardhurat nga pagat e dokumentuara për subjektin ⁴⁶ dhe pagat për bashkëshortin e saj⁴⁷; të ardhura nga shitja e pasurive sipas kontratave përkatëse të shitblerjeve; të ardhura nga bursa e djalit për rezultate në shkollë.

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur duke u bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit. Përbërja familjare për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve është ndarë në këto periudha: për vitin 2003 një person, nga viti 2004 deri më 17.7.2005 për dy persona; nga lindja e djalit deri më 28.10.2007 për tre persona dhe nga lindja e djalit të dytë deri më 31.12.2016 për katër persona. Janë përfshirë shpenzimet e shkollimit⁴⁸; shpenzimet për mobilim sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard; shpenzime për pushime sikurse është deklaruar nga subjekti në DPV-të e viteve përkatëse. Shpenzimet e udhëtimit bazohen në raportin nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësorin standard. Metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, të datës 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Pasuritë, ku përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit/es. Çdo pasuri është regjistruar në atë datë/vit kur është paguar. Secila nga pasuritë është analizuar në kohën e krijimit të saj. Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e shitblerjeve, deklaratat noteriale, mandatpagesat, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të. Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në krijimin e pasurisë së fundit.

- Likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive në një zë të veçantë: gjendjet e llogarive bankare⁴⁹ në fund të çdo viti/date të analizuar për çdo person të familjes.

Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor.

Rezultati është i përlllogaritur për çdo vit kalendarik, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e: *Të ardhura – (Shpenzime + Pasuri neto)*.

Mundësia financiare është analizuar për çdo pasuri të krijuar në momentin e pagesës për pasurinë.

B. KONTROLI I FIGURËS

DSIK-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017 mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita N. Ndoi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (1) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (2) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (3) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale

⁴⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 5.10.2016, nga Prokuroria Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër; vërtetim nr. ***, datë 27.3.2020; vërtetim nr. *** prot., datë 7.10.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; vërtetim datë 19.1.2017, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; pagesat gjatë lejes së lindjes nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”.

⁴⁷ISSh – vërtetim për bazën e vlerësueshme për punësimet në drejtorinë vendore të Policisë Berat; Drejtoria e Policisë Qarkut Korçë; Drejtoria e Policisë Dibër; Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë; Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë; aparat Drejtorisë së Policisë së Shtetit; vërtetim nr. *** prot., datë 20.3.2020, nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Drejtoria e Policisë së Shtetit; vërtetim nga z. A. C. datë 24.1.2017, për periudhën e punësimit 15.10.2015-31.12.2016.

⁴⁸Nga lëvizjet e llogarisë së “Raiffeisen Bank”, shkresa nr. *** prot., datë 26.2.2019.

⁴⁹Shih: Shkresa nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Raiffeisen Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 20.2.2019, nga “Credins Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 25.2.2019, nga “ProCredit Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 8.3.2019, nga “Tirana Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 21.11.2019, nga “OTP Bank”.

apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita N. Ndoi.

Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni kërkoi përditësim të dhënash në lidhje me subjektin e rivlerësimit, për të cilin DSIK-ja⁵⁰ informoi se për këtë subjekt ka kryer kërkime për përditësim informacioni, nga të cilat nuk rezultuan të dhëna.

Gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur asnjë të dhënë të cilitdo burim për veprimtari korruptive apo kontakte me persona të papërshtatshëm në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni, nuk u konstatuan elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga neni DH i Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të procesit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, bazuar në:

1. Raporti për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dërguar me shkresën nr. * prot., datë 24.4.2020, nga ku rezultuan gjetjet si më poshtë:**

Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Afërdita Ndoi, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Ajo ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në dokumentet ligjore të vëzhguara është analizuar norma penale dhe procedurale penale e zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Rezulton se qëndrimet e prokurorit janë mbështetur nga drejtuesi i Prokurorisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurorja. Rezulton se prokurorja vë në pah përfundime lidhur me elementë konkretë të figurës së veprës penale objekt hetimi, kur arrin në përfundimin se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale për të cilën është akuzuar.

Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

⁵⁰ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2020, nga DSIK-ja në dosjen e Komisionit.

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi, në periudhën e rivlerësimi 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të saj ligjore, konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune me profil të lartë gjatë periudhës së rivlerësimi.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimi, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve. Vendimi i mosfillimit i procedimit penal është marrë brenda afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Referuar të dhënave statistikore për punën e kryer, rezulton se prokurorja ka përballuar me efikasitet një ngarkesë të lartë pune duke marrë në konsideratë edhe faktin që një periudhë të gjatë kohore në periudhën objekt rivlerësimi, ka qenë me raport për probleme shëndetësore. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimi, prokurorja Afërdita Ndoi, është eficient dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimi, prokurorja Afërdita Ndoi, tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mire” për aftësitë organizative, sipas treguesve vjetorë të punës.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe disponimin e gjykatës.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimi në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimi tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimi, prokuroren Afërdita Ndoi, nuk është marrë asnjë masë disiplinore duke u vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguar prej saj, sipas treguesve vjetorë të punës.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Afërdita Ndoi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tre dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna që cenojnë aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe të dhëna nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Afërdita Ndoi, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit është deklaruar se është angazhuar në dy aktivitete profesionale (seminare) të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në disa aktivitete të zhvilluara.

2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, konkretisht informacioni i marrë nga:

2.1 Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave gjatë procesit të rivlerësimit, rezultuan të njëjtat gjetje si ato në raportin e KLP-së, duke mos u evdinentuar problematika dhe elementë që çënojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

2.2 Një denoncim nga publiku, i paraqitur sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 nga denoncuesja A. S.⁵¹, ne te cilin kjo shtetase, duke paraqitur detaje nga çështja e saj e pronësisë, denoncon disa prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të cilët edhe prokuroren Afërdita Ndoi, të cilët sipas saj, po e padisin dhe kallëzojnë padrejtësisht. Konkretisht, për subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, denoncuesja ka ngritur disa pretendime për vlerësimin e të cilave Komisioni administroi aktet e dosjes penale të vëna në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë⁵². Pas analizimit të materialeve të dosjes, Komisioni evidentoi në mënyrë të detajuar pretendimet e denoncueses,

⁵¹Shihni denoncimin nga znj. A. S., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 10.1.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵²Shihni dosjen penale dërguar me shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 27.4.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

të cilat i vuri në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, duke iu kërkuar sqarime për seicilin prej tyre.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Së pari: në lidhje me pretendimin e denoncuases se prokurorja pasi ka marrë në shqyrtim kallëzimin penal të kallëzuesit D. B. ndaj të akuzuarës A. S. për veprën penale ‘dhunim banese’, ka ndryshuar objektin e kallëzimit, nga dhunim banese në mashtrim pa autor, subjekti ka sqaruar se prokurori me marrjen e kallëzimit vlerëson nëse materiali kallëzues përmban fakte, të cilat krijojnë një dyshim për ekzistencën e veprës penale. Prokurori, në detyrën e tij funksionale në momentin e regjistrimit të procedimit, nuk bazohet te dispozitat ligjore që ka referuar kallëzuesi, por kryen një analizë ligjore të dispozitës që dyshohet se është cenuar dhe mbi këtë bazë urdhëron regjistrimin e veprës penale në regjistrin e procedimeve. Përfundimisht, nga ana e saj si prokurore nuk është proceduar me mosfillimin e procedimit pasi nuk jemi para rasteve të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale që nuk lejojnë fillimin e procedimit. Në analizë të provave të administruara deri në atë fazë, fakti përbënte veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe, në këto kushte, është proceduar me regjistrimin e procedimit për këtë veprë penale.

Për më tepër, sipas subjektit, pretendimet e paraqitura nga denoncuesja janë paraqitur edhe në gjykim nga e dëmtuara dhe kërkesat e saj janë gjetur të pambështetura në ligj dhe janë rrëzuar. Vendimmarrja e prokurorit është vlerësuar e drejtë si në gjykimin në seancë paraprake ashtu edhe në gjykimin në themel të kësaj çështjeje penale.

Së dyti: për sa pretendohet nga denoncuesja se prokurorja ka kryer veprime arbitrare gjatë hetimit të çështjes, duke urdhëruar paraqitjen e oficerit gjyqësor bashkë me ekspertin topograf dhe punonjësit e policisë për verifikimin e apartamentit të saj, veprime që i kanë shkaktuar asaj ankth, subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se veprimet e saj hetimore janë kryer në përputhje me nenet 198 dhe 201 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave është proceduar me këqyrjen e banesës ku banonte shtetasja A. S. Konkretisht, në nenin 198 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar “rastet dhe format e këqyrjes”: *“1. Këqyrja e personave, e vendeve dhe e sendeve vendoset nga organi procedues kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të veprës penale. 2. Kur vepra penale nuk ka lënë gjurmë ose pasoja materiale ose kur këto janë zhdukur, kanë humbur, janë ndryshuar a lëvizur, organi procedues përshkruan gjendjen dhe, kur është e mundur, verifikon se si ka qenë ajo para ndryshimeve, si dhe merr masa që të saktësojë mënyrën, kohën dhe shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur. 3. Organi procedues mund të urdhërojë fotografime, filmime dhe çdo veprim tjetër teknik”*.

Sipas subjektit, neni 201 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“1. Të pandehurit dhe atij që ka në dispozicion vendin ku do të bëhet këqyrja ose sendin që do të këqyret u dorëzohet në fillim kopja e vendimit për kryerjen e këqyrjes. 2. Në këqyrjen e vendeve, organi procedues mund të urdhërojë për arsye të motivuara, që të pranishmit të mos largohen para se të ketë përfunduar këqyrja dhe t’i kthejë forcërisht ata që largohen”*.

Së treti: për sa pretendohet nga denoncuesja se prokurorja nuk u shpreh për pafajësinë e shtetasës A. S. lidhur me procedimin penal për sa i takon veprës penale dhunim banese të kallëzuar nga shtetasi D. B., subjekti, në parashtrimet e saj ka sqaruar se për sa kohë që Prokuroria nuk ka regjistruar ndonjë procedim në ngarkim të saj, nuk mund të ketë as një vendim fajësie apo pafajësie. Jo vetëm që nuk është marrë në ndjekje penale, por ajo është konsideruar si viktimë e veprës penale. Pretendimi i saj që ndihet e kërcënuar nga ndjekja penale nuk ka lidhje me këtë procedim, pasi ky procedim ka mbaruar se hetuari dhe gjykuari

në shkallë të parë dhe ajo nuk është marrë në përgjegjësi penale për ndonjë veprim të kundërligjshëm. Frika që ajo parashtron për këtë rast është joreale dhe e pakuptueshme.

Së katërti: lidhur me pretendimin se prokurorja nuk është shprehur me vendim për kërkesat e përsëritura të znj. A. S., për ta legjitimuar si palë paditëse në procedimin penal për veprën penale ‘vjedhje me anë të mashtrimit’, kundër shtetasës Sh. I., në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar se padia civile në procesin penal gjen rregullim në nenet 61 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Në këto dispozita është parashikuar momenti i legjitimit të padisë civile në procesin penal. Pavarësisht se në nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se “*Legjitimimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor*”, organi i vetëm procedural që legjitimon padinë civile në procesin penal është gjykata. Ky konkluzion del edhe më i qartë në pikën 3 të së njëjtës dispozitë që parashikon se “*Me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal*”, si dhe nenin 354 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se kërkesa për legjitimetin e paditësit bëhet në fazën e kërkesave paraprake dhe për kërkesat paraprake është gjykata që disponon.

Së pesti: në lidhje me vendosjen e sekuestros preventive disa muaj pas kërkesave të znj. A. S., në parashtrimet e saj subjekti ka sqaruar se menjëherë pas regjistrimit të emrave të të dyshuarve është kryer hetim pasuror i tyre për identifikimin e pasurisë. Deri në momentin që çështja është dërguar për gjykim nuk është identifikuar asnjë pasuri që mund të sekuestrohej. Në këto kushte nuk është vendosur sekuestro preventive.

Së fundi: lidhur me mospajisjen e denoncueses me vendimin dhe inventarin e dosjes, në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar se ky pretendim është i pavërtetë pasi shtetasja A. S. ka firmosur së bashku me avokatin e saj procesverbalin për përfundimin e hetimeve. Pas marrjes së kopjes së akteve në sekretarinë gjyqësore ajo ka paguar shpenzimet me marrjen e akteve në shumën 8.300 lekë, vërtetuar me procesverbalin e përfundimit të hetimeve dhe mandatpagesës.

Përveç sa më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit vendimin nr. ***, datë 25.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve Sh. I. dhe A. S. për veprën penale “mashtrim me pasoja të rënda, kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 6 vjet burgim.

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, në vlerësim të të gjitha fakteve e rrethanave, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit kundërshtoi çdo pretendim të denoncueses bazuar në fakte e dispozita ligjore, duke argumentuar bindshëm se, në çdo rast, veprimet e saj në kuadër të këtij procedimi penal kanë qenë të mbështetura në ligj e prova.

3. Informacioni i marrë nga të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime, nga ku për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar se: (i) nuk ka pasur masa disiplinore; (ii) nuk ka të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm; (iii) për dy materiale hetimore të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në ngarkim të subjektit është vendosur mosfillimi i procedimit penal; (iv) për pesë ankesa të periudhës 2006 – 2018, të cilat janë marrë në shqyrtim nga drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, janë sqaruar pretendimet e paraqitura nga ankuesit; (v) nga të dhënat për vlerësimin e punës të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti është vlerësuar në nivel “shumë mirë”.

4. Informacioni i publikuar në media në [linkun https://pamfleti.net/durres-prokurorja-aferdita-vatnikaj-banorja-e-lura-lalz-qe-cprangosi-e-ktheu-ne-detyre-lusiena-kolen-e-bandes-lame-gjuzi/](https://pamfleti.net/durres-prokurorja-aferdita-vatnikaj-banorja-e-lura-lalz-qe-cprangosi-e-ktheu-ne-detyre-lusiena-kolen-e-bandes-lame-gjuzi/), sipas të cilit ngriheshin pretendime në lidhje me një vendimmarrje të ndikuar të subjektit të rivlerësimit për rikthimin në detyrë të shtetasës L. K., ish-punonjëse e Kadastrës Durrës.

Në lidhje me këtë informacion, gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës dosjen e procedimit penal të shtetas L. K., trajtuar nga prokurorja Afërdita Ndoi⁵³, nga shqyrtimi i së cilës u konstatua se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 24.9.2019 (kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përfaqësuar nga prokurori A. N.) ka vendosur të vlerësojë të ligjshëm ndalimin e shtetas L. K., e dyshuar për kryerjen e veprës penale 'shpërdorim detyre', caktimin e masës së sigurimit personal 'detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore' ndaj shtetas L. K., caktimin e masës së sigurimit personal 'pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës deri në përfundim të hetimeve paraprake. Gjithashtu, urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetas L. K. nga komisariati i policisë Durrës.

- Ndaj këtij vendimi, në datën 25.9.2019, shtetasja L. K. ka paraqitur ankim duke kërkuar ndryshimin e tij sa i takon caktimit të masës së sigurimit personal ndalues 'pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' në ASHK Durrës deri në përfundim të hetimeve paraprake.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës (prokurorja Afërdita Ndoi), në konkluzionet e saj mbi ankimin e vendimit penal nr. ***, datë 24.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 24.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe heqjen e masës së sigurimit 'pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' në ASHK Durrës deri në përfundim të hetimeve paraprake në ngarkim të personit nën hetim L. K., duke parashtruar se: *'... ajo nuk ka mohuar në asnjë moment veprimet e kryera nga ana e saj që të krijojë dyshimin se mund të manipulojë në të ardhmen provat; kushtet familjare që ajo parashtron që është e divorcuar dhe jeton vetëm me një fëmijë të mitur dhe nuk ka të ardhura të tjera për të jetuar duhen marrë në konsideratë nëse duhej vendosur kjo masë; janë sekuestruar dokumentacioni ku dyshohet dhe janë evidentuar shkeljet, e në këtë mënyrë ajo nuk ka mundësi të ndikojë mbi to; të dhënat kompjuterike në lidhje me aplikimin dhe çdo lëvizje në lidhje me këto dosje janë marrë nga prokuroria nëpërmjet procesverbalit të këqyrjes; në këtë mënyrë nisur nga provat e administruara mundësia e të dyshuarës për të ndikuar te provat është minimale në detyrën funksionale që ajo kryen aktualisht. Në këto kushte çmohim se vendosja e masës së sigurimit 'pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' në ASHK Durrës deri në përfundim të hetimeve paraprake, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale nuk ka qenë e domosdoshme dhe shkakton pasoja për personin nën hetim'.*

- Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2019 (referuar shkurtim vendimi) vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 24.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sa i përket disponimit për caktimin e masës së sigurimit ndaluese 'pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik'; rrëzimin e kërkesës së prokurorit të çështjes për caktimin e masës ndaluese të parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale në ngarkim të shtetas L. K.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi qëndrimin e saj në konkluzionet e parashtruara në Gjykatën e Apelit Durrës, në lidhje me heqjen e masës së sigurimit 'pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik' deri në përfundim të hetimeve paraprake në ngarkim të personit nën hetim L. K.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e saj, në lidhje me këtë çështje, subjekti ka sqaruar se bazuar në nenin 148 të Kushtetutës dhe në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori është i pavarur, çka do

⁵³Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.7.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në dosjen e Komisionit.

të thotë që qëndrimi i tij mbi çështjen bazohet vetëm në bindjen e brendshme në përputhje me provat dhe ligjin.

Në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga ana e saj për heqjen e masës së sigurimit ‘pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik’ në ngarkim të personit nën hetim L. K., zonja Ndoi ka sqaruar se ka vlerësuar rrethanat e parashtruara në konkluzionet e saj para gjykatës si shkallën e fajit dhe llojin e shkeljes së kryer, rrezikshmërinë e personit në hetim, rrezikun që paraqiste vazhdimi i detyrës nga personi nën hetim për çështjen konkrete, si dhe rrethanat familjare të saj, konkretisht:

- në lidhje me shkallën e shkeljes së ligjit dyshohej se personi nën hetim kishte plotësuar një regjistër të regjistrimit të pronave në mënyrë të paautorizuar dhe se ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën” e parashikonte këtë shkelje si kundërvajtje;
- veprimet e të dyshuarës nuk paraqisnin rrezikshmëri të lartë shoqërore në bazë të akteve të administruara deri në ato momente;
- qëndrimi subjektiv i të dyshuarit ndaj veprës penale ishte shprehje e pendimit pasi pranonte veprimin e kryer duke dhënë shpjegime në lidhje me arsyet që e kishin çuar për të kryer një veprim të tillë;
- gjendja sociale në të cilën ndodhej e dyshuara e cila ishte e divorcuar dhe jetonte me të birin 12-vjeçar dhe siguronte jetesën me të ardhurat nga puna.

Më tej, subjekti ka deklaruar se në qëndrimet e tij i është referuar vetëm ligjit dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, duke ushtruar e pandikuar, me integritet e pastërti, detyrën e saj si prokurore.

Për të hequr çdo dyshim mbi integritetin e saj profesional, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit qëndrimin e saj ligjor të mbajtur në një rast tjetër të ardhur për gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës, me person nën hetim po me shtetasen L. K., në të cilin ajo ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur të mos pranojë kërkesën e kërkuases L. K. të datës 22.11.2019, me objekt revokimin e masës ndaluese “pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”.

Pas analizimit të akteve të dosjes penale dhe argumenteve të subjektit të rivlerësimit, sa i takon konkluzioneve të paraqitura para Gjykatës së Apelit Durrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, Komisioni nuk konstatoi qëndrime të saj në tejkallim apo në shkelje të parashikimeve ligjore. Këto konkluzione i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, e cila ka kërkuar gjithashtu ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës sa i përket disponimit për caktimin e masës së sigurimit ndalues ‘pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik’, ashtu sikurse ishte parashtruar edhe nga prokurorja Afërdita Ndoi. Nga ana tjetër, qëndrimi i mbajtur prej subjektit në një tjetër çështje penale me person nën hetim shtetasen L. K., por jo në favor të saj, vlerësohet nga Komisioni si element që dëshmon paanësinë e subjektit të rivlerësimit për rastin objekt shqyrtimi.

5. Denoncim anonim i paraqitur për subjektin e rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ.

Në datën 15.9.2020, pas mbylljes së hetimit administrativ, për subjektin e rivlerësimit Afërdita Ndoi u administrua një denoncim anonim protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.9.2020, i cili kishte për objekt dy informacione të publikuara në mediat *online*, si vijojnë:

- “Prokurorja Afërdita Vatnikaj, banorja e Lura – Lalz, që çprangosi e ktheu në detyrë L. K. e bandës ***”;
- “skandali – prokurorja mban 7 vjet peng dosjen e vdekjes për mjekim të gabuar”.

Pas vënies në dijeni të këtyre dy informacioneve, Komisioni, me vendimin nr. 3, të datës 15.9.2020, vendosi të riçelë hetimin administrativ, duke kryer disa veprime hetimore shtesë me qëllim verifikimin e tyre.

Së pari, pavarësisht se me informacionin e parë Komisioni ishte njohur edhe më parë dhe kishte administruar dosjen e procedimit penal në ngarkim të shtetases L. K., duke qenë se në këtë denoncim ngriheshin pretendime se prokurorja Afërdita Ndoi ka pasuri në kompleksin e shoqërisë “****” sh.p.k., iu kërkua informacion kësaj shoqërie, e cila në pergjigjen e saj⁵⁴ informoi Komisionin se nuk ka lidhur kontrata shitjeje, sipërmarrjeje, kapari, etj., me subjektin e rivlerësimit Afërdita Ndoi dhe personat e lidhur me të. Në përfundim të hetimit shtesë nuk u konstatuan pasuri të tjera të fshehura në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të në kompleksin e shoqërisë “****” sh.p.k., dhe jo vetëm.

Së dyti, lidhur me informacionin e dytë për zvarritjen e hetimit prej 7 vjetësh të çështjes penale që i përket shtetases Sh. M., e cila ka humbur jetën si pasojë e mjekimit të gabuar dhe mbylljen e çështjes nga prokurorja Afërdita Ndoi pa kryer hetime të plota, pas riçeljes së hetimit administrativ u administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dosja e procedimit penal nr. *** e vitit 2013.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i të gjitha akteve të ndodhura në dosje u evidentuan në rend kronologjik veprimet procedurale dhe hetimore të kryera, si vijojnë:

Në datën 6.12.2011, bashkëshorti i viktimës, shtetasi N. M., ka paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kallëzim penal për mjekun gjinekolog Sh. B. si shkaktar i vdekjes së bashkëshortes, i cili e kishte mjekuar për dy muaj, por pa përcaktuar ndonjë diagnozë apo sëmundje.

Mbi bazën e këtij kallëzimi, në datën 13.12.2011 është regjistruar materiali kallëzues dhe për nevoja të këtij procedimi penal, nga subjekti i rivlerësimit janë kryer këto veprime hetimore: në datën 20.12.2011 është urdhëruar thirrja e shtetasis N. M., i cili është pyetur më 1.2.2012; në datën 13.2.2012 është pyetur shtetasja L. M. (motra e viktimës); në datën 17.2.2012 është pyetur shtetasi Sh. B.; në datën 22.2.2012 është vendosur sekustrimi i kartelës klinike të shtetases Sh. M. nga QSUT-ja dhe në klinikën “****”; në datën 13.3.2012 është vendosur kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor; në datën 5.6.2012 i është kërkuar Institutit të Mjekësisë Ligjore kryerja dhe dërgimi i aktit në një kohë sa më të shpejtë; në datën 20.6.2012 është administruar aktekspertimi mjeko-ligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, i cili informon se e ka dërguar këtë akt që më 4.6.2012.

Në datën 18.6.2012 prokurorja Afërdita Ndoi ka vendosur: (1) mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. **, datë 13.12.2011, pasi fakti nuk përbën vepër penale; (2) njoftimin e vendimit pranë institucionit të Urdhrit të Mjekut për trajtimin nga ana administrative të rastit, nëse ekzistojnë kushtet për marrjen e masave administrative ndaj mjekut Sh. B. për neglizhencën në punën e tij të konstatuar nga aktet e mësipërme.

Në këtë vendim, subjekti ka arsyetuar se bazuar në aktet e hetimit dhe provat e grumbulluara nuk është kryer vepra penale “mjekim i pakujdesshëm” parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Sipas subjektit kjo dispozitë parashikon që: *“Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porosive të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 5 vjet”*. Në vijim arsyetohet se, sipas aktit mjeko-ligjor nr. **, datë 1.6.2012, grupi i ekspertëve të mjekësisë ligjore ka konkluduar se: (1) në trajtimin e shtetases Sh. M. vihen re

⁵⁴Shih shkresën kthim-përgjigje datë 21.9.2020, nga shoqëria “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

elementë të mjekimit të pakujdesshëm në formën e neglizhencës mjekësore të konstatuara këto në fazën e diagnostikimit të saj dhe konsistojnë në moskryerjen e disa ekzaminimeve të domosdoshme për zbulimin e kësaj sëmundje siç janë Colposkopia, biopsia e qafës së mitrës, skaneri dhe rezonanca manjetike etj.; (2) këto mangësi kanë ndikuar në mosvënien në një kohë sa më të shpejtë të diagnozës dhe, për pasojë, në mjekim të vonuar dhe shpejtim të vdekjes së kësaj shtetaseje. Bazuar në këtë akt, subjekti ka vlerësuar se në kushtet kur mungon lidhja shkakësore mes veprimeve të mjekut Sh. B. dhe ardhjes së pasojës së vdekjes, ky kallëzim penal duhet mosfilluar, por duhet mbajtur në konsideratë në marrjen e masave administrative ndaj tij.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal të datës 18.6.2016, marrë prej subjektit të rivlerësimit, u kundërshtua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga shtetasi N. M. dhe me vendimin nr. ***, datë 13.3.2013, kjo gjykatë vendosi prishjen e vendimit datë 18.6.2012 të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme pranë kësaj prokurorie, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 17.7.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në vendimin nr. *** Akti, datë 13.3.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pasi ka vlerësuar veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, ka evidentuar mosveprimet e saj në cilësinë e prokurores, duke lënë detyra konkrete.

Në vlerësim të veprimeve hetimore të kryera nga subjekti deri në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, bazuar në të gjitha provat shpresore të administruara, si dhe referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 13.3.2013, në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se:

(i) Hetimet e prokurores Afërdita Ndoi, nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues datë 13.12.2011 e deri në vendimin e mosfillimit datë 18.6.2012, kanë zgjatur 6 muaj, në kundërshtim me udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 24.10.2006.

(ii) Vendimi për kryerjen e aktekspertimit mjeko-ligjor është marrë në datën 13.3.2012, pra, tre muaj nga data e regjistrimit të procedimit penal (datë 13.12.2011), ndërkohë që në datën 5.6.2012, pra, tre muaj më vonë, i është kërkuar Institutit të Mjekësisë Ligjore kryerja dhe dërgimi i aktit në një kohë sa më të shpejtë, fakte që tregojnë zgjatje të afatit të hetimeve.

(iii) Referuar vendimit nr. ***, datë 13.3.2013, të gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer disa veprime hetimore të përmendura specifikisht në këtë vendim.

Në vijim, me urdhrin e datës 24.9.2013, prokurorja Afërdita Ndoi, mbi bazën e vendimit nr. ***, datë 13.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm” të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, pa emër personi të cilit i atribuohet vepra penale.

Me urdhërin e datës 30.9.2013, prokurorja Afërdita Ndoi ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të lëna detyrë nga gjykata. Konkretisht, për nevoja të këtij procedimi penal, nga subjekti janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: në datën 21.11.2013 është urdhëruar paraqitja e shtetasve V. Q.; E. K., S. C., të pyetur përkatësisht në datat 27.12.2013, 2.12.2013, 17.1.2014 dhe 5.2.2014; në datën 22.12.2013 është kërkuar informacion nga Urdhri i Mjekut se çfarë është bërë në rastin konkret dhe nëse është marrë ndonjë vendim për mjekun Sh. B.; në datën 27.1.2014 u bë ballafaqimi i shtetasve L. M., N. M., Sh.B.; në datën 15.5.2014 (tetë muaj më vonë se fillimi i veprimeve hetimore) është vendosur kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor dhe caktimin e ekspertëve, mjekë më të mirë në fushën konkrete për dhënien përgjigje të pyetjeve të shtruar për ekspertim nga prokurori; në datat 4-5.11.2014 janë marrë deklaratat e

ekspertëve; në datën 24.11.2014 është administruar ekspertiza mjekësore nga Urdhri i Mjekëve Tiranë, sipas së cilës grupi i mjekëve arrijnë në konkluzionin se: *“Nuk konstatojmë elementë të mjekimit të pakujdesshëm gjatë trajtimit apo ndërhyrjeve mjekësore që i janë bërë shtetasës Sh. M. Vdekja e pacientes nuk ka ardhur nga mjekimi i pakujdesshëm apo vonesa në diagnostikimin e sëmundjes së pacientes po nga sëmundja e rëndë malinje dhe stadi i avancuar i saj, gjë që ka çuar në përsëritjen e sëmundjes me gjithë mjekimin korrekt që i është bërë”*.

Në datën 10.12.2014 prokurorja Afërdita Ndoi vendosi pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 24.9.2013, pasi fakti nuk përbën veprë penale, duke arsyetuar se bazuar në aktet e hetimit, vdekja e pacientes nuk ka ardhur nga mjekimi i pakujdesshëm apo vonesa në diagnostikimin e sëmundjes së pacientes, por nga sëmundja e rëndë malinje dhe stadi i avancuar i saj, gjë që ka çuar në përsëritjen e sëmundjes me gjithë mjekimin që i është bërë pacientes.

Ndaj vendimit të pushimit të datës 10.12.2014, shtetasi N. M. paraqiti ankim dhe gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, vendosi shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 24.9.2013, dhe kthimin e çështjes Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për rifillimin e hetimeve në lidhje me detyrat e caktuara, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.***, datë 17.2.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në vendimin e saj, gjykata ka konstatuar se gjatë veprimeve hetimore të prokurores Afërdita Ndoi janë bërë dy aktekspertime, të cilat kundërshtojnë njera-tjetrën dhe, për këtë arsye, i ka lënë prokurorisë si detyrë kryerjen e një akti të ri ekspertimi nga një grup ekspertësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore duke përcaktuar tri pyetje konkrete.

Në datën 6.3.2017 prokurorja Afërdita Ndoi ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal nr. *** të vitit 2013. Pas kësaj kërkesë drejtuesi i prokurorisë P. F. ka vendosur zëvendësimin e saj me prokurorin tjetër A. K.

Në vlerësim të veprimeve hetimore të kryera nga subjekti deri në marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 24.9.2013, bazuar në të gjitha provat shkresore të administruara, si dhe referuar vendimit nr. ***, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimit administrativ, duket se:

(i) Mungojnë faqet e urdhrimit të subjektit për kryerjen e veprimeve hetimore (në dosje ekziston vetëm faqja e parë që referon vetëm fillimin e procedimit penal sipas vendimit të gjykatës).

(ii) Nga data e regjistrimit të procedimit penal datë 24.9.2013 e deri në vendimin e pushimit të tij datë 10.12.2014, pavarësisht se procedimi penal është regjistruar pa emër personi që i atribuohet vepra penale, hetimet kanë zgjatur 1 vit e tre muaj. Ndërkohë, vërehet se vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor dhe caktimin e ekspertëve është marrë në datën 15.5.2014, pra, tetë muaj pasi kishte filluar hetimi i procedimit penal, ç'ka ka sjellë përsëri vonesa në hetimin e çështjes.

(iii) Gjatë veprimeve hetimore subjekti është përballur me dy aktekspertime, të cilat kundërshtojnë njëri-tjetrin. Në këto kushte nuk rezulton që të jetë kryer nga subjekti ndonjë veprim hetimor në lidhje me verifikimin e vërtetësisë së këtyre akteve të ndryshme mjeko-ligjore dhe për këtë shkak, gjykata ka lënë si detyrë pikërisht caktimin e një grupi të ri ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Në përfundim të hetimeve pas riçeljes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës në lidhje me konstatimet e përmbledhura si vijon. Duket se:

1. Hetimet e prokurores Afërdita Ndoi, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal datë 13.12.2011 dhe deri në vendimin e mosfillimit datë 18.6.2012, kanë zgjatur 6 muaj, në tejkalim

të afatit deri 20-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 24.10.2006, ndërkohë që veprimet hetimore të kryera duket që nuk e justifikojnë këtë afat. Vendimi për kryerjen e aktekspertimit mjeko-ligjor është marrë në mënyrë të pakuptueshme në datën 13.3.2012, pra tre muaj më vonë nga data e regjistrimit të procedimit penal, ç’ka ka sjellë si pasojë zgjatje të afatit të hetimeve.

2. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, datë 13.12.2011, të shtetasit N. M., duket se vjen në kundërshtim me ushtrimin e detyrës së prokurorit nga subjekti, e cila në kushtet e një ekspertize mjeko-ligjore, që parashikon elementë të mjekimit të pakujdesshëm nga mjeku, në formën e neglizhencës mjekësore të konstatuara këto në fazën e diagnostikimit të saj dhe konsistojnë në moskryerjen e disa ekzaminimeve të domosdoshme për zbulimin e kësaj sëmundjeje ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që duhet të kishte regjistruar procedimin penal për veprën penale të mjekimit të pakujdesshëm sipas nenit 96 të Kodit Penal dhe të kishte vijuar hetimet për të vërtetuar ose jo këtë akuzë në ngarkim të shtetasit Shkëlqim Balili.

3. Pas vendimit nr. ***, datë 13.3.2013, të Gjykatës së Tiranës, i cili e ktheu çështjen për hetime të mëtejshme nga data e regjistrimit të procedimit penal datë 24.9.2013 e deri në vendimin e pushimit të tij datë 10.12.2014, hetimet kanë zgjatur 1 vit e tre muaj. Pavarësisht se procedimi penal është regjistruar pa emër, personi që i atribuohet vepra penale, veprimet hetimore të kryera duket se nuk e justifikojnë këtë afat. Vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor dhe caktimin e ekspertëve është marrë në mënyrë të pakuptueshme tetë muaj më vonë, më 15.5.2014, ç’ka ka sjellë përsëri vonesa në hetimin e çështjes.

4. Në dosjen penale mungojnë faqet e urdhrit të datës 30.9.2013, ku prokurorja Afërdita Ndoi ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore sipas vendimit nr. ***, datë 13.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Vendimet e prokurores Afërdita Ndoi lidhur me këtë çështje janë rrëzuar nga dy gjykata me vendime të formës së prerë për mungesë hetimesh të plota.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pasi u njoh me konstatimet e mësipërme, në prapësimet e datës 6.10.2020, subjekti ka parashtruar si vijon:

1. Në lidhje me konstatimin e parë, sa i takon afateve të hetimit përpara marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal, subjekti ka parashtruar:

Së pari: çështja në fjalë është ende në shqyrtim dhe sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin nr. ***, datë 5.10.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit procedimi penal nr. 4975, me datë regjistrimi 24.9.2013, rezulton që ndiqet nga prokurori A. K. dhe aktualisht çështja është në hetim.

Së dyti: referuar praktikës gjyqësore dhe në zbatim të neneve 184 dhe 185 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor në të gjitha rastet e mjekimit të pakujdesshëm është ndër veprimet e fundit hetimore që ndërmerren, me qëllim që eksperti të ketë një tablo të plotë të faktit e të provave.

Së treti: trajtimi i materialit kallëzues konkret ishte kompleks dhe i një shkallë të lartë vështirësie dhe në këto kushte, prej janë kryer veprime të vazhdueshme dhe të njëpasnjëshme, duke mos pasur asnjë zvarritje të pajustificuar. Së katërti: Kodi i Procedurës Penale në nenet

290⁵⁵ dhe 291⁵⁶ nuk parashikonte afate për regjistrimin e materialit kallëzues dhe për këtë arsye, detyra e saj për verifikimin e materialit kallëzues nuk mund të limitohet në kohë. Në rendin hierarkik të ligjit, Kodi i Procedurës Penale qëndron mbi urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga subjektet procedurale, duke referuar vendimin nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese në të cilin parashikohet se: *“Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët iu nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njeri-tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Gjyqtarët duhet të kenë parasysh edhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit.”*

Vlerësimi i Komisionit

Së pari: për sa pretendohet nga subjekti lidhur me ndalimin e vlerësimit të aftësive profesionale mbi çështjet në shqyrtim, Komisioni çmon se është e vërtetë që sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim dhe subjekti ka vërtetuar se çështja është ende në shqyrtim. Megjithatë Komisioni vlerëson se, pavarësisht se çështja është ende në fazë shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit nuk është më përfaqësues i organit të akuzës në këtë çështje, pasi ka dhënë dorëheqjen. Në këtë këndvështrim, ky ndalim do të kishte kuptim nëse subjekti i rivlerësimit do të ishte ende prokurori aktual i çështjes. Veç kësaj, dy vendime të subjektit, një vendim mosfillimi dhe një vendim pushimi janë prishur nga gjykata me vendime, të cilat pas ankimimit kanë marrë formë të prerë.

Së dyti: për sa pretendohet nga subjekti se vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor është ndër veprimet e fundit hetimore që ndërmerren, referuar praktikës gjyqësore në rastet e trajtimit të mjekimit të pakujdesshëm dhe në zbatim të neneve 184⁵⁷ dhe 185⁵⁸ të Kodit të Procedurës Penale, nga Komisioni vlerësohet se: (i) subjekti nuk ka sjellë asnjë rast nga praktika gjyqësore ku janë trajtuar raste të ngjashme; (ii) është e vërtetë që në zbatim të këtyre dispozitave, përpara aktit të ekspertimit kryhen veprime të tjera hetimore, por, parashikimi i nenit 184 të K.P.P, sipas të cilit, eksperti mund të autorizohet nga organi i procedurës që të shohë aktet, dokumentet dhe

⁵⁵ Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale përcakton rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit.

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur: (a) personi ka vdekur; (b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale; (c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin; (ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; (d) vepra penale është shuar; (dh) është dhënë amnisti; (e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

⁵⁶ Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale vendimi për mosfillimin e procedimit 1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

⁵⁷ “1. Për t’iu përgjigjur kërkesave të ekspertimit, eksperti mund të autorizohet nga organi procedues që të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës. 2. Eksperti mund të autorizohet të marrë pjesë edhe në pyetjen e palëve dhe marrjen e provave. 3. Kur eksperti kërkon të dhëna nga i pandehuri, i dëmtuari ose nga persona të tjerë, këto të dhëna përdoren vetëm për qëllimet e ekspertimit. 4. Kur për nevojat e ekspertimit është i domosdoshëm shkatërrimi ose ndryshimi i thelbit të sendit, kur është e mundur, ekspertët detyrohen të ruajnë atë pjesë të tij, si dhe të dokumentojnë pjesën e përdorur për ekspertim, duke vënë në dijeni organin procedues dhe palët.”

⁵⁸ “1. Mendimi i ekspertit jepet me shkrim. 2. Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë mendime të ndryshme, seciliparashtron me akt të veçantë mendimin e tij. 3. Kur faktet janë komplekse dhe eksperti nuk mund të japë përgjigje menjëherë, organi procedues i jep atij një afat jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Kur ka nevojë për verifikime veçanërisht komplekse ky afat mund të zgjatet edhe më shumë se një herë për periudha jo më të gjata se tridhjetë ditë, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh.”

gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës, nuk detyron organin që kërkon ekspertimin, në këtë rast prokurorin, që të kryejë të gjitha veprimet hetimore përpara se të urdhërojë ekspertimin. Nga ana tjetër, kryerja e veprimeve hetimore, përfshirë dhe ekspertimin mjeko-ligjor, duhet të jetë në proporcion me afatin e verifikimit të kallëzimit penal, i cili është 20 ditë.

Së treti: për sa pretendohet nga subjekti se trajtimi i materialit kallëzues konkret ishte kompleks dhe i një shkallë të lartë vështirësie dhe nga ana e prokurores janë kryer veprime të vazhdueshme, nga Komisioni vlerësohet se nuk qëndron pasi në rastin konkret, referuar akteve të dosjes penale, që nga data e regjistrimit të procedimit penal datë 13.12.2011 deri më 13.3.2012, kur është urdhëruar ekspertimi nga ana e subjektit, janë kryer vetëm një numër minimal verifikimesh, konkretisht, janë pyetur shtetasit N. M. më 1.2.2012, L. M. më 13.2.2012, Sh. B. më 17.2.2012, janë sekuestruar kartelat klinike më 22.2.2012 dhe, së fundi, në datën 13.3.2012 është vendosur kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor, pas një muaji nga dita e veprimit të fundit hetimor ose 3 muaj nga data e regjistrimit të materialit kallëzues. Në këtë mënyrë, duket se caktimi i datës së ekspertimit më 13.3.2012, nuk justifikohet me veprime konkrete hetimore apo shkaqe të tjera objektive.

Së katërti: pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në kushtet kur Kodi i Procedurës Penale nuk parashikonte afate dhe, për këtë arsye, detyra e saj për verifikimin e materialit kallëzues nuk mund të limitohet në kohë, nga Komisioni vlerësohet se nuk qëndron pasi:

a. Kodi i Procedurës Penale në atë periudhë, në nenet 290 dhe 291 të tij, nuk parashikonte afate për regjistrimin e procedimit penal, pra, ka pasur një vakuim ligjor, i cili është plotësuar nga ligjvënësi me ndryshimet që iu bënë Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017, sipas të cilit *“prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”*.

b. Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale (nenit 24 pika 4 dhe 287 e vijues të tij) si dhe në pikën 2, të nenit 8, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, *“Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar, me qëllim pikërisht për të normuar veprimtarinë e prokurorëve lidhur me afatet e verifikimit të kallëzimeve penale në mungesë të një parashikimi të tillë në ligj.

c. Nuk jemi përpara një konflikti normash mes Kodit të Procedurës Penale dhe Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm (i cili ka e në fuqi gjatë hetimit të çështjes).

d. Referimi i subjektit të vendimi nr. 2, datë 3.2.2010, i Gjykatës Kushtetuese, nuk vlerësohet i bazuar, pasi ligji (Kodi i Procedurës Penale, i cili nuk ka përcaktuar afate) dhe akti nënligjor, në rastin konkret udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar (i cili përcakton një afat), të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes (kryerjen e hetimeve), nuk bien në kundërshtim me njeri-tjetrin, përkundrazi, udhëzimi ka dalë në zbatim të ligjit me qëllim limitimin në kohë të kryerjes së hetimeve, me qëllim evitimin e zvarritjeve në kushtet kur ligji nuk kishte parashikuar afate.

2. Në lidhje me konstatimin e dytë, subjekti ka deklaruar se në asnjë rast nuk ka vepruar në kundërshtim me ushtrimin e detyrës së prokurorit, por ka vepruar sipas ligjit, bazuar në bindjen e saj të brendshme. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti ka sjellë në vëmendje argumentet si vijojnë:

- Sipas subjektit, prokurori në asnjë rast nuk mund të regjistrojë procedim kur ka bindje se fakti nuk përbën vepër penale, pasi kjo përbën fillim të paligjshëm të ndjekjes penale, e cila parashikohet si vepër penale në nenin 313 të Kodit Penal. Ka qenë bindja e saj si prokurore e bazuar në prova dhe ligj për të konkluduar në mosfillimin e procedimit në mungesë të elementëve të veprës penale në rastin konkret.

- Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 4, datë 12.1.2011, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ku, ndër të tjera, thuhet se: *“E drejta për të filluar dhe regjistruar një procedim penal për një veprë penale të kryer nga një person është një e drejtë që mund ta ushtrojë vetëm organi i akuzës. Në rastin konkret, kjo e drejtë është ushtruar në mënyrë të paligjshme nga gjykata, e cila në këtë çështje ka shkelur edhe parimin e paanësisë dhe barazisë së palëve në proces”,* si dhe vendimin nr. 222, datë 12.9.2012, ku ndër të tjera thuhet se: *“Në kuptim e zbatim të ligjit procedimi penal fillon mbi bazën e të dhënave të marra me iniciativë nga prokurori, policia gjyqësore ose të njoftuara nga subjekte të tjera që duhet të tregojnë veprën penale dhe në rastet kur është e ditur edhe autorët. Por këto të dhëna duhet t’i nënshtrohen një verifikimi paraprak të kujdesshëm për të arritur në përfundime të drejta nëse fakti konkret parashikohet si veprë penale duke pasur parasysh dhe kërkesat e nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, që nuk lejon nisjen e procedimit penal dhe të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, që thekson se kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit penal.”*

- Më tej, subjekti argumenton se: *... paanshmëria në gjykimin e materialit kallëzues duket qartë edhe në faktin se i ka përcjellë Urdhrit të Mjekut kërkesën për të vlerësuar shkeljet dhe marrjen e masave disiplinore për mjekun Sh. B. Ky është ndër rastet e rralla për të mos thënë i vetmi në praktikën gjyqësore që mjeku është dërguar për t’iu nënshtruar procedurës disiplinore kur është konkluduar për pafajësinë, pushimin apo mosfillimin e procedimit. Vendimmarrja e saj është kontrolluar dhe nga drejtuesit e Prokurorisë, të cilët e kanë gjetur të drejtë vendimmarrjen duke e sigluar vendimin e mosfillimit ...*

- Lidhur me aktekspertimin, subjekti argumenton se: *“... aktekspertimi sqaron se mangësitë e krijuara në lidhje e mjekimin, mund të kenë ndikuar në shpejtimin e ardhjes së vdekjes së kësaj shtetaseje, vdekje kjo e cila për shkak të kësaj sëmundje të rëndë dhe vdekjeprurëse të zbuluar në një stad të avancuar të saj, nuk mund të shmangej”*.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni iu referua nenit 148 të Kushtetutës dhe nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave prokurori në ushtrimin e funksioneve të tij është i pavarur, çka nënkupton që qëndrimi i tij mbi çështjet bazohet vetëm në bindjen e brendshme në përputhje me provat dhe ligjin. Gjithashtu Komisioni i është referuar pikës 4 të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit *vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, dispozitë e cila konsiderohet, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*

Nderkohë, Komisioni çmon se, vendimet nr. 4, datë 12.1.2011 dhe nr. 222, datë 12.9.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilave subjekti u referohet, mbështesin pretendimet e tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni e vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, si të bazuar në bindjen e brendshme, në vlerësim të fakteve dhe provave të grumbullura gjatë procesit të hetimit. Për më tepër, qëndrimi i mbajtur në vijimësi nga organi i akuzës në lidhje me këtë çështje penale, ka qenë i njëjtë me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit.

3. Në lidhje me konstatimin e tretë, sa i takon tejkallimit të afateve të hetimit deri në marrjen e vendimit të pushimit, subjekti ka parashtruar se veprimet e saj kanë qenë të vazhdueshme dhe të njëpasnjëshme, duke shpjeguar se: *“... çështja ka qenë komplekse dhe e një shkallë të lartë vështirësie. Vendimi i ekspertimit është marrë pasi janë kryer veprimet hetimore si marrja e deklaramëve të mjekëve, ballafaqimet etj., të cilat ishin të nevojshme për t’iu vënë në dispozicion ekspertëve për të kryer aktin. Ndaj dhe akti si veprim procedural është kryer i fundit, pasi ka*

qenë e domosdoshme që ekspertët të kishin të dhëna sa më të plota për kryerjen e riekspertimit. Sikurse u theksua edhe më lartë është detyrim ligjor që vendimi për kryerjen e ekspertimit të jetë veprimi i fundit hetimor, pasi ekspertëve duhet t'u vihen në dispozicion të gjitha provat e dosjes". Sipas subjektit, kësaj çështjeje i është kushtuar kujdesi i duhur në hetimin sa më të shpejtë dhe të drejtë, pavarësisht ngarkesës shumë të lartë në punë, duke vënë në dispozicion të dhëna statistikore për ngarkesën e saj në punë për vitet 2012 – 2014.

Për sa pretendohet nga subjekti se çështja ka qenë komplekse dhe e një shkalle të lartë vështirësie dhe se prej saj jenë ndërmarë veprime hetimore të vazhdueshme dhe të njëpasnjëshme, nga Komisioni vlerësohet si një pretendim jo tërësisht i bazuar, referuar faktit që veprimet hetimore të evidentuara në mënyrë konkrete e të shprehur nga Gjykata, janë kryer brenda një kohe relativisht të gjatë dhe me distancë kohore të konsiderueshme nga njëra-tjetra. Konkretisht, veprimet e para hetimore janë kryer pas më shumë se 2 muajsh nga data e regjistrimit të procedimit penal, ndërkohë që kryerja e aktekspertimit është vendosur pas 8 muajve nga data e regjistrimit të procedimit penal ose pas 4 muajve nga veprimi i mëparshëm hetimor.

4. Në lidhje me konstatimin e katërt, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore duke sqaruar se mungesa e urdhrin duhet të ketë qenë një gabim gjatë fotokopjimit të materialeve të dosjes. Nga përmbajtja e urdhrin të vënë në dispozicion me parashtrimet, vërehet se subjekti ka urdhëruar kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të lëna detyrë nga gjykata.

5. Në lidhje me konstatimin e pestë, subjekti ka deklaruar se vendimet e pushimit janë prishur nga gjykata jo për pamjaftueshmëri të hetimit, por për vlerësim të ndryshëm të provave të administruara, ndërkohë që në vendimin e saj me nr. *** Akti, datë 13.3.2013, gjykata është shprehur se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka realizuar një hetim të plotë e të gjithanshëm, duke evidentuar konkretisht veprimet hetimore të munguara. Ndërsa me vendimin ***, datë 29.6.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke evidentuar dy aktekspertimet të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën, përsëri ka kërkuar kryerjen e hetimeve të tjera nga organi i prokurorisë, duke caktuar një grup ekspertësh.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se qëndrimi i prokurorisë në trajtimin e kësaj çështjeje ka qenë i njëjti pavarësisht prokurorit të ngarkuar me hetimin e saj, çka tregon njëtrajtshmëri në qëndrimin e prokurorisë në vlerësimin dhe çmuarjen e provave të administruara, fakt i cili është i vërtetë, referuar të gjitha qëndrimeve që ka mbajtur organi i akuzës në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Arsyetim ligjor

Gjatë procesit të vendimarrjes, për një vlerësim sa më objektiv të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i është referuar:

(1) Fakteve, rrethanave dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, si vijojnë : (i) vlerësimeve pozitive nga ana e KLGJ dhe Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit në të gjithë komponentët; (ii) faktit që për këtë subjekt rivlerësimi ka pasur vetëm një denoncim nga publiku, pretendimet e të cilit rezultuan të pabazuara në prova e në ligj dhe dy denoncime anonime, për njërin prej të cileve⁵⁹, u vertetua se pretendimet nuk qëndronin; (iii) problematikat e evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, si kohëzgjatja e pajustificuar e hetimeve apo rrëzimi dy herë i vendimeve me vendim të formës së prerë nga gjykata, i përkasin një çështjeje të vetme, procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, rast i papërsëritur nga subjekti në vijim të ushtrimit të funksionit të prokurores.

⁵⁹ Denoncimi lidhur me procedimin penal në ngarkim të shtetases L. K.

(2) Opinionit të Komisionit të Venecias⁶⁰ dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁶¹ të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

(3) Nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon rastet e prezumuara për marrjen e masave ndëshkuese për subjektet e rivlerësimit. Referuar kësaj dispozite ligjore, në procesin e vlerësimit tërësor të të gjithë komponenteve të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se, nuk ndodhemi përpara ndonjë prej parashikimeve ligjore të kesaj dispozite, pasi nuk u vërtetua që subjekti: (i) *ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij*, pika 3; (ii) *ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit*, pika 4; (iii) *kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët sa që rrezikon ose cënon të drejtat e qytetarëve*, pika 5.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se problematikat e evidentuara gjatë hetimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, nuk sjellin për pasojë papërshtatshmërinë në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Në bindjen e trupit gjykues, këto problematika janë të pamjaftueshme gjithashtu, për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut sipas nenit 61 pika 5 e ligjit nr.84/2016, kjo edhe në konsiderate të faktit se qëndrimi i mbajtur në vijimësi nga organi i akuzës në lidhje me këtë çështje penale (edhe pasi subjekti ka hequr dorë nga çështja), ka qënë i njejtë me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit.

Për më tepër, në zbatim të pikës 1, të nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara në ligj dhe jo i bazuar në një burim të vetëm vlerësimi e aq më pak të një çështjeje të vetme⁶².

Por, referuar gjetjeve të evidentuara, të cilat si më sipër u arsyetua, janë produkt i një çështjeje të vetme dhe jo produkt i një procesi vlerësimi në tërësi, Komisioni vlerësoi të transferojë çështjen që i përket procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, pranë organit kompetent, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur

⁶⁰ Shih opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias

⁶¹ Shih vendimin nr.2, dt.18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese

⁶² Shih vendimin e KPA, Nr. 11 regjistër (JR) Nr. 25 i vendimit, datë 01.10.2020, paragrafi nr.114.

nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 8.6.2020, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegime dhe opinione lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

Në datën 8.10.2020 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Afërdita Ndoi, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit të saj, ka qenë tërësisht e gatshme dhe bashkëpunuese, duke iu përgjigjur në çdo rast pyetjeve brenda afateve të caktuara nga Komisioni. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi qëndrimin e saj korrekt e objektiv, si gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu edhe në parashtrimet e saj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, të nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Afërdita Ndoi, prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Durrës.

2. Transferimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. 4975, të vitit 2013, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datë 08.10.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Anëtare/Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare/Kundër

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka